

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7659 E diel 23 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** **Ditës**
Numërohen ndoshta me gishtat e njërës dorë, në këto 106 vite histori të shtetit tonë, ata drejtues institucionesh kryesore të shtetit që kanë gjetur ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Nuk jeni vetëm znj. Marku


Dje **në "Deutsche Welle"**
Të themi qysh në krye të herës: populistët e djathtë të "Alternativa për Gjermaninë" (AfD) nuk ofrojnë asgjë, asgjë fare për zgjidhjen e problemeve ...
Vijon në faqen 22

Nga JENS THURAU
Gjermani thirri arsyes!



Kufizim për mjetet e prodhuara para 2009

Nga 1 janari do ndalohet importi i makinave mbi 10 vjet të përdorura

Ministri i Mjedisit, Klosi: Ç' do ndodhë me 60 mijë automjetet e futur rishtazi

ORNELA MANJANI

Duke nisur nga data 1 janar 2019, në Shqipëri do të ndalohet importi i makinave të përdorura mbi 10 vjet pradhim. Në ditën pa makina, ministri i Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi ka prezantuar këtë projektvendim ...

Në faqen 7

SUPEROPERACIONI/ ARRESTIME NE SHQIPERI DHE HOLANDE, AKUZAT E PLOTA

SHKATERROHET GRUPI "BAJRI", 11 NE PRANGA

Goditen "të fortët" e Shkodrës, policia: Dyshojmë për dy vrasje, trafik droge dhe gjobëvënie. Reagon BE: Operacioni, në bashkëpunim me forca policie të BE



(Në foto) Operacioni "Forca e ligjit". Safet Bajri, Armir Grima



"SHERR" PAS ARRESTIMEVE

"Bajre", Rama: Punë disamujore e policisë, Kryemadhi: I ke pasur truproje

Në faqen 4

MINISTRI I FINANCAVE

Ahmetaj: Monitorim transaksioneve, pa asnjë kosto shtesë për biznesin

Në faqen 6

INCIDENTI

Piloti spanjoll i dehur, policia kufitare bllokoi fluturimin në Rinas

Në faqen 8

EMRAT

Mashtrim me 350 milionë lekë të reja ndaj shtetit, 4 vetë në pranga

Në faqen 8

KANDIDATET



Lista e dytë, emrat dhe datat për 860 mësuesit që hyjnë në provim

Në faqen 9-11



Zbulohen artikujt e Kolë Macës në shtypin përtej Adriatikut 1 shekull më parë

Imazhet e Shqipërisë në Itali, të vitit 1907

Në brendësi: "Teatri" nga Ben Andoni. Një ekspeditë jo vetëm austriake

NGA QERIM VRIONI

Një nga fotografët më të shquar shqiptar të gjysmës së parë të shekullit të kaluar, mbetet pa dyshim Kolë Maca (1882-1945). Mësimet e para në lëm të "dhomës së erret", ai i mori si të thuasht vjedhurazi në studion e artistit



dhe mjeshtrit shkodran, Kolë Idromeno, ku punoi qysh djale i ri, si ndihmës (sipas bisedës me piktorin Ndoc Gurashi, Shkodër, tetor 2012). Më pas, Maca ka thelluar njohuritë e tij mbi proceset fotografike në Austri (Gjithmonë sipas bisedës me N.Gurashin) ...

Suplement

GODITET GRUPI 'BAJRI' HETIMET

FSHF: Presim verdiktin e drejtësisë për Armir Grimën

Kush është trajneri i Kombëtares së femrave, i arrestuar si pjesë e bandës "Bajri"

Një ndër personat e arrestuar nga policia si pjesë si pjesë e grupit kriminal të Safet Bajrit është dhe Armir Grima. 44-vjeçari ka qenë portier i ekipit të futbollit të Villaznisë në vitet 1998-2001, kohë kur ky ekip është shpallur kampion. Grima ka qenë edhe drejtor teknik i skuadrës, ndërsa ka mbajtur herë pas here edhe pozicionin e trajnerit. Në vitin 2013 ai ishte në listën e kandidatëve të PD-së për deputet. Pas arrestimit të tij ka reaguar Federata Shqiptare e Futbollit. "FSHF në qëndrimin e saj është e prirur të besojë në pafajësinë e plotë dhe mospërfshirjen të trajnerit Armir Grima në rrjetet kriminale për të cilën është



Ish-portieri i Villaznisë Armir Grima

ndaluar nga ana e autoriteteve të rendit. FSHF mbetet shumë sensitive karshi kësaj ngjarjeje, por

njëherësh është në pritje të zbardhjes së plotë të akuzës që rëndon mbi trajnerin Grima, duke pritur verdiktin e drejtësisë. Një moment i tillë nuk mund të përbëjë objekt sulmi karshi Armirit, për sa kohë drejtësia nuk ka dhënë vendimin e saj, madje as nuk ka nisur ende të bëjë punën e saj", -thuhet në njoftimin e publikuar nga FSHF. Gjithashtu, Federata thekson se "do të ndjekë me shumë qetësi dhe seriozitet ecurinë e kësaj ngjarjeje. "Duke ftuar njëherësh të gjithë të presin mbylljen e procesit dhe të frenojnë emotivitetin e tyre momental karshi z.Grima që mbetet një familjar i shkëlqyer dhe një njeri me reputacion dhe personalitet të lartë në ambientin e futbollit shqiptar, dhe jo vetëm".



Arrestimet gjatë operacionit "Forca e ligjit"

Hetimet, dokumentohet dhe ekzekutimi i Arben Tuzit në 2001-shin

"Fundoset" Behar Bajri, prokuroria: Vrau gruan e tij 15-vjeçare, Fabiolën Ngjarja në vitin 2002 u raportua si vetëvrasje

Pak orë pas operacionit të koduar "Oazi" ku u vunë në pranga 11 persona, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me aktivitetin e këtij grupi kriminal që drejtohej nga Enver Bajri (i shpallur në kërkim) dhe ku rol të rëndësishëm kishin dhe Safet e Behar Bajri. Burime zyrtare nga Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda në Tiranë bënë me dije se kanë arritur të dokumentojnë deri tani me fakte shkencore dy vrasje të ndodhura në Shkodër. Bëhet fjalë për ngjarjen e rëndë të ndodhur më 7 shkurt të vitit 2001, ku u vra shtetasi Arben Tuzi si dhe ngjarjen e datës 20 qershor të vitit 2002, ku u vra 15-vjeçarja Fabiola Bajri (ish-gruaja e Behar Bajrit). Arben Tuzi u ekzekutua në rrugën "Vasil Shanto" në Tiranë, ndërsa për këtë ngjarje akuzohen Behar Bajri dhe Ilir Bajri. Hetimet për këtë ngjarje janë zhvilluar më vonë. Pas 17 vitesh është rihapur kjo dosje, në atë kohë Behar Bajri ka qenë 20 vjeç. Edhe Ilir Bajri ka qenë shumë i ri. Vrasja e dytë, për të cilën akuzohen Bajret është ajo e minorenes. Vajza u gjet e pajetë në banesën e Behar Bajrit. Vrasja e Fabiola Bajrit u raportua në atë kohë si vetëvrasje. Mësohet se ekzekutimi i 15-vjeçares u zbulua për shkak të pozicion-



it të plumbit që kishte marrë poshtë parakrahut. Prova e fortë që fundosit Bajret ishte pistoleta, e cila rezultoi se ishte e njëjta që ishte përdorur edhe për vrasjen e Arben Tuzit. Me këtë të fun-

dit familja Bajri kishte konflikte të vazhdueshme, të cilat kishin shkuar deri në përleshje me armë apo dhe me vrasje. Në aksionin e fundit të policisë, Behar Brajoviq (Bajri) u arrestua në

Roterdam të Holandës, ndërsa djali i xhaxhait, Safet Bajri u kap në Tiranë. Ndërkaq, sipas burimeve zyrtare nga prokuroria, Behar Bajri dhe Ilir Bajri akuzohen për shumë krime të tjera. Me

datë 28.01.2000 në fshatin Dobrac, Behar Bajri në bashkëpunim me kushëririn e tij, Sead Rustemi ka vrarë me armë zjarri shtetasin Petrit Demiri, punonjës i Policisë Rrugore në Komisaratiin e Policisë Shkodër. Me datë 18.08.2006 shtetasi Behar Bajri është akuzuar për përdhunimin e dy vajzave të mitura, krim të cilin e ka kryer në bashkëpunim me një tjetër person. Me datë 14.01.1999, në lagjen "Vojo Kushi", janë vrarë me armë zjarri vëllezërit Osman e Artur Alibali. Autorë të dyshuar të kësaj ngjarjeje kanë rezultuar të jenë shtetasit Behar Bajri, Ilir Bajri dhe Frederik Totaj. Kjo vrasje është kryer menjëherë mbas vjedhjes me armë të kryer ndaj dy shtetasve nga Berati.

Ministri Xhafaj:
"Forca e ligjit" goditi goditi grupin më të rrezikshëm të Veriut

TRIANË - Në lidhje me operacionin që çoi në shkatërrimin e grupit "Bajri" reagoi dje ministri i Brendshëm, Fatos Xhafaj. Përmes një postimi në "Twitter". Xhafaj tha se "Forca e ligjit" goditi njëkohësisht në Shkodër, Tiranë dhe Roterdam, me disa të arrestuar për një nga grupet kriminale më të rrezikshëm në veri të vendit. "Një tjetër super-aksion policor në kuadër të operacionit "Forca e ligjit" nga ana e Task Forcës Speciale Qendrore të Policisë së Shtetit në bashkëpunim me prokurorinë. Operacioni "Forca e ligjit" goditje ndëshkuese njëkohësisht në Shkodër, Tiranë dhe Roterdam (Holandë), me disa të arrestuar për një nga grupet kriminale më të rrezikshëm në veri të vendit", u shpreh Xhafaj.

Prokuroria sekuestron resortin në Velipojë dhe një lokal me vlerë disa mln euro

Shkatërrohet grupi kriminal "Bajri", bien në pranga 11 të "fortët" e Shkodrës dhe 2 në kërkim

Operacioni "Oazi" u zhvillua në Shqipëri e Holandë, i shpëton arrestimit "koka" e bandës, Enver Bajri

Policia e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda në Tiranë kanë goditur dhe shkatërruar një nga grupet me të rrezikshme kriminale në veri të vendit tonë. Bëhet fjalë për bandën "Bajri", e cila prej shumë vitesh ishte kthyer në tmerrin e banorëve të qytetit verior. 11 persona janë arrestuar gjatë operacionit të koduar "Oazi" që u shtri në Tiranë, Shkodër dhe Rotterdam të Holandës. Ndërkohë, blutë nuk arritën të vinin në pranga Enver Bajrin, i cili konsiderohet si drejtuesi i këtij grupi kriminal. 45-vjeçari është shpallur në kërkim bashkë me një tjetër person me inicialet N.H.. Sipas hetimeve të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Enver Bajri është personi që drejtonte të gjithë punën grupit nga trafiku i drogës deri tek gjobëvënie.

Mësohet se Enver Bajri është djali i xhaxhait të Safet Bajrit. Ky i fundit u arrestua të premtën në Tiranë, ndërsa cilësohet si i forti i Shkodrës. Pas operacionit të suksesshëm, kreu i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe kryeprokuroerja e Krimeve të Rënda, në një konferencë për shtyp bënë publikë emrat e personave të arrestuar, disa prej të cilëve u kapën në Holandë dhe të tjerët në Shqipëri. Operacioni në fjalë në kuadër të Operacionit "Forca e ligjit". Po të njëjtat burime sqaruan se në zbatim të urdhrit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda u sekuestruan një resort-hotel në Velipojë dhe një lokal në Shkodër, pasi dyshohet se janë produkt i ardhur nga aktiviteti kriminal. Po ashtu u sekuestruan edhe 3 automjete dhe një numër i konsiderueshëm celularësh.

HETIMET
Mësohet se veprimet hetimore, nën drejtimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, deri në goditjen e plotë të gjithë grupit kriminal "Bajri" kanë zgjatur mbi 6 muaj. Burime zyrtare thanë se hetimet u bazuat tek dhjetëra orë përgjime, mijëra informacione të shkëmbyera me partnerët, u analizuan mijëra faqe të dhëna, si edhe u kryen ve-



Drejtori i Policisë së Shtetit Ardi Veliu gjatë konferencës për shtyp

AKUZAT NDAJ ANËTARËVE TË GRUPIT "BAJRI"

1. "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë", në bashkëpunim
2. "Vrasje me dashje", e kryer në bashkëpunim
3. "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake"
4. "Organizim i lotarive të palejuara"
5. "Pastrim i produkteve të veprës penale" të kryer në bashkëpunim
6. "Shtërngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie të pasurisë" kryer në bashkëpunim
7. "Përkrahje e autorit të krimit"
8. "Moskallëzim krimi"
9. "Prodhim e shitje e lëndëve narkotike"

KOKA E GRUPIT KRIMINAL

Policia nuk mundi të vinte në pranga Enver Bajrin, i cili konsiderohet si drejtuesi i këtij grupi kriminal. 45-vjeçari është shpallur në kërkim bashkë me një tjetër person me inicialet N.H.. Sipas hetimeve të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Enver Bajri (djali i xhaxhait të Safet Bajrit) është personi që drejtonte të gjithë punën e grupit nga trafiku i drogës deri tek gjobëvënie.

primes pro-aktive në terren, përme kontrollit nga ajri (dron) dhe vëzhgimit intensiv. Oficerë të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me oficerë të përfshira në operacion, kanë kryer veprime në terren për evidentimin, lokalizimin dhe ndalimin e shtetasve anëtarë të grupit, që vepronin jashtë Shqipërisë, e kryesisht në Holandë. Akuzat ndaj anëtarëve të këtij grupi kriminal janë: "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë", në bashkëpunim, "Vrasje me dashje", e kryer në bashkëpunim,

"Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake", "Organizim i lotarive të palejuara", "Pastrim i produkteve të veprës penale" të kryer në bashkëpunim, "Shtërngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie të pasurisë", kryer në bashkëpunim, "Përkrahje e autorit të krimit", "Moskallëzim krimi", "Prodhim e shitje e lëndëve narkotike", vepra penale këto të kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Si vepra të rënda kriminale, të dokumentuar deri tani janë 2 vrasje të

SEKUESTRIMI I PASURIVE

Gjatë operacionit të koduar "Oazi", i cili zgjati nga mesdita e së premtës dhe deri në orët e para të mëngjesit të djeshëm, tre anëtarëve të grupit kriminal "Bajri" iu gjetën në trup dhe iu sekuestruan 3 pistoletë, ndërsa në banesë kanabis sativa. Policia në zbatim të urdhrit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda ka sekuestruar 1 resort-hotel në Velipojë dhe 1 lokal në Shkodër në pronësi të tyre, pasi dyshohet se janë produkt i ardhur nga aktiviteti kriminal. Gjithashtu, janë sekuestruar edhe 3 automjete e një numër i konsiderueshëm celularësh.

OPERACIONI "OAZI"

TË ARRESTUARIT

1. Behar Brajoviq (Bajri) i arrestuar në Rotterdam, Holandë
2. Samet Halluni, i arrestuar në Rotterdam, Holandë
3. Ilir Rustemi, i arrestuar në ndërhyrjen e datës 6 shtator në Shkodër
4. Emrah Plaku, i arrestuar në ndërhyrjen e datës 6 shtator në Shkodër
5. Astmer Bilali, i arrestuar në ndërhyrjen e datës 6 shtator në Shkodër
6. Armir Grimaj, arrestuar në Shkodër
7. Safet Rustemi (Bajri), i arrestuar në Tiranë
8. Fabiol Rexhepi, i arrestuar në Shkodër
9. Ismet Idrizi, i arrestuar në Shkodër
10. Denis Brajoviq, i arrestuar në Tiranë
11. Klaudio Hoxhalliu, i arrestuar në Tiranë.

NË KËRKIM


1. Enver Bajri, 45 vjeç
2. N.H., 34 vjeç

ndodhura në Shkodër, ngjarje e ndodhur në 7 shkurt 2001, ku u vra shtetasi A.T., dhe ngjarje e datës 20 qershor 2002, ku u vra shtetasja E.H., 15 vjeçe. Gjatë veprimeve hetimore ka rezultuar edhe është provuar në javët e fundit, se anëtarë të këtij grupi kriminal kanë kanosur dhe shtrënguar disa shtetas për dhënie shumash të konsiderueshme parash. Ky grup është i dyshuar dhe po hetohet intensivisht për disa nga ngjarjet e fundit të ndodhura në Shkodër. Grupi "Bajri", në bashkëpunim edhe me grupe të tjera kriminale, brenda dhe jashtë Shqipërisë, dyshohet se trafikonin lëndë të forta narkotike në shtete europiane dhe më pas paratë e përfuturuar nga ky aktivitet investoheshin brenda vendit. Operacioni policor për arrestimin e personave të më-

sipërm është zhvilluar njëkohësisht në Tiranë, Shkodër dhe në Rotterdam, Holandë dhe zgjati nga mesdita e së premtës dhe deri në orët e para të mëngjesit të ditës së sotme. Ndërhyrja operacionale është koordinuar mes grupeve të posaçme hetimore, në të dy shtetet duke shkëmbyer informacion intensiv. Gjithashtu, u ngritën dhe operuan në 2 vendet, grupe të përbashkëta operacionale, të mbështetura nga forcat speciale të Policisë së Shtetit dhe atyre holandeze. Gjatë ditëve të operacionit për identifikimin dhe arrestimin e disa prej personave të mësipërm janë shkëmbyer me dhjetëra informacione, jo vetëm mes policisë së këtyre 2 shteteve, por edhe autoriteteve ligjzbatuese që asistojnë prokurorinë dhe policinë, në Gjermani, Kroaci etj.



Kapja e Safet Bajrit, mediat belge: Do merrte kontrollin e prostitucionit



TIRANË. Një nga emrat më të përfolur të botës së krim-it është arrestuar mbremjen e së premtës në Tiranë. Bëhet fjalë për Safet Bajrin (Rustemi), i cili njihet si i "forti" i Shkodrës. Shkodrani akuzohet për trafik droge e prostitucion nga autoritetet belge. Për këto akuzat ai është dënuar nga Apeli në Bruksel me 9 vite burgim. Nderkaq në Shqipëri Safet Bajri akuzohet për trafik droge, vrasje, gjobëvënie e shantazh. Një ditë pas arrestimit, mediat belge kanë shkruar se Safet Rustemi konsiderohet nga autoritetet si një nga kriminelët më të rrezikshëm në Europë. "Rustemi do të bënte 22 vjet burg në Belgjikë, por Zyra e të Huajve e kishte dëbuar atë. Familja e tij ka kryer disa vrasje në Shqipëri. Në Belgjikë, Rustemi u përpoq të merrte kontrollin e prostitucionit në Bruksel duke përdorur dhunën", shkruan një nga gazetaret belge.

BANDA E BAJREVE REAGIMET

Arrestimi i Bajreve përgëzohet nga Bashkimi Europian, akuza nga opozita

Paloka: Bushati të sqarojë sa herë ka takuar Bajret. Ministri: Gjuhë e përdalë

Rama: "Forca e ligjit" po përshkallëzohet

Darina Tanushi

Operacioni i policisë që çoi në shkatërrimin e grupit kriminal "Bajri" solli dje, reagime të ndryshme në radhët e politikës shqiptare. Kryeministri Edi Rama përgëzoi Policinë e Shtetit për këtë operacion ku u arrestuan 11 persona të konsideruar të rrezikshëm. Përmes një statusi në Twitter, kryeministri Rama shkroi dje: "Policia e Shtetit foli përsëri me forcën e vendosmërisë sonë në luftën kundër kriminit. "Forca e ligjit" prangosi rrjetin kriminal të Shkodrës pas një pune policore disamujore të shtrirë edhe jashtë vendit. Respekt dhe për vendosmërinë e prokurorisë. "Forca e ligjit" po përshkallëzohet." Reagim pozitiv erdhi edhe nga ambasadori i Bashkimit Evropian në Tiranë Luigi Soreca. Ambasadori Soreca përshëndeti operacionin, të cilin e vlerësoi si të rëndësishëm, ndërkohë që përmendi se lufta ndaj kriminit të organizuar dhe trafikut të drogës është prioritet për Shqipërinë dhe BE-në. Por, opozita vijoi me akuzat e saj. Nënkrjetari i PD, Edi Paloka shkroi në rrjetet sociale duke ngritur pikëpyetje nëse në përgjimitet e Bajreve kishte dalë edhe emri i ministrit të Jashtëm, Ditmir Bushati. Por, vetë ministri Bushati, njëherësh edhe i deleguar i PS-së dhe i qeverisë për qarkun e Shkodrës u shpreh se kjo ishte një tentativë e PD-së për të kriminalizuar kundërshtarin politik. Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati tha dje: "Sot është një ditë e mirë për Shkodrën falë vendosmërisë sonë në luftën me krimin. Gjuhët e përdala të atyre që krimin e duan për politikë dhe politikën e bëjnë për të kriminalizuar kundërshtarin, konfirmojnë suksesin e sotëm. E gjithë vëmendja shkodranëve". Ndërsa nga ana e tij, nënkryetari i PD-së, Edi Paloka u shpreh: "Meqë ministri i Ramës vendosi të "flasë" dhe po tund flumurin e fitores kundër kriminit në Shkodër, pse nuk i përgjigjet disa pyetjeve të tjera: - Sa herë është takuar me Bajret? - Sa herë i ka përdorur për të kërcënuar përfaqësues dhe votues të opozitës? - Sa vota iu ka kërkuar në zgjedhje që t'i bëjnë me "mënyrën e tyre"? - Sa herë iu ka qar "selam" në emër të Ramës? - Çfarë date mban komunikimi i fundit i tij me Bajret?".



EDI RAMA

"Policia e Shtetit foli përsëri me forcën e vendosmërisë sonë në luftën kundër kriminit. "Forca e ligjit" prangosi rrjetin kriminal të Shkodrës pas një pune policore disamujore të shtrirë edhe jashtë vendit. Respekt dhe për vendosmërinë e Prokurorisë. "Forca e ligjit" po përshkallëzohet",- shkroi dje, Rama.

ISH-PRESIDENTI

BUJAR NISHANI

Pas aksionit të Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe agjencive të huaja ligjzbatuese, ka ardhur reagimi i ish-presidentit të Republikës, Bujar Nishani. Në një koment në faqen e Twitter-it të Ministrisë së Brendshme, Nishani komenton dhe shkruan: "Më në fund një punë e mirë!"



AMBASADORI I BE

LUIGI SORECA

"Përhëndes operacionin e rëndësishëm të zhvilluar në Shqipëri dhe Holandë nga Punët e Brendshme, task forca speciale në bashkëpunim me disa forca policie të BE-së. Lufta ndaj kriminit të organizuar dhe trafikut të drogës është prioritet për Shqipërinë dhe BE-në",- u shpreh ambasadori i BE-së.



DEPUTETI PS

ERION BRAÇE

Erion Braçe ironizoi opozitën me deklaratat e saj duke i kërkuar që të hënin të shkojnë sërisht në Shkodër tek ai hoteli dhe me vete të marrin edhe "Volin e revoltime". "A është kush në punë të thotë ndonjë fjalë? Nga Holanda serioze e bashkëpunuese deri te budallai Lul, ka ndonjëri gjë për të thënë?!", shkroi Braçe.



Berisha: Autoritetet e huaja të hetojnë lidhjet e Bajreve me Ramën e Bushatin

Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar pas aksionit të policisë, për arrestimin e 11 personave, pjesë e grupit "Bajri" në Shkodër. Berisha ka përgëzuar autoritetet ligjzbatuese të Mbretërisë së Belgjikës dhe Holandës për operacionin në fjalë. Po ashtu ai u bëri thirrje autoriteteve të këtyre vendeve të hetojnë dhe bëjnë publike lidhjet e ngushtë të drejtuesve të kësaj bande, komunikimet direkte të tyre me Ramën,



Ditmir Bushatin dhe Luan Harushën, drejtues kryesor të policisë. "Me këtë rast le t'u bëjmë thirrje autoriteteve të këtyre vendeve të hetojnë dhe bëjnë publike lidhjet e ngushtë të drejtuesve të kësaj bande,

komunikimet direkte të tyre (tabuletat) me kreun e meduzës, Edvin Kristaq Rama, Ditmir Sulejman Bushatin, Luan Harushën, drejtues kryesor të policisë, prokurorisë dhe gjykatave në Shkodër dhe Tiranë, udhëheqës dhe protektor të bandës së Bajreve, kriminit shqiptar dhe ndërkombëtar. Ky do të ishte një kontribut i jashtëzakonshëm për Shqipërinë dhe rajonin tonë, stabilitetin e tyre", u shpreh dje, Berisha.



PD akuzon kryeprokuroren: Shpërdoroi detyrën

Alibeaj: Prokuroria e Tiranës të hetojë Arta Markun, shkatërroi hetimet për Tahirin

Partia Demokratike i bëri dje, thirrje Prokurorisë së Tiranës të urdhërojë menjëherë pezullimin nga detyra të kryeprokurores Arta Marku. Deputeti demokrat Enkelejd Alibeaj tha se kryeprokuroria ka shpërdoruar detyrën. "Shpërdorimi i detyrës nga Arta Marku është një çështje që kërkon hetim të shpejtë nga Prokuroria e Tiranës, për të mos lejuar shkatërrimin e mëtejshëm të çështjeve Tahiri, Shullazi apo ndonjë dosjeje tjetër për të cilën është shqetësuar Edi Rama. Partia Demokratike i bën thirrje Prokurorisë së Tiranës të urdhërojë pa vonesë pezullimin nga detyra të Arta Markut dhe të nisë hetimin ndaj saj", u shpreh Alibeaj. Sipas Partisë Demokratike, hetimet e prokurorisë duhet të zbulojnë edhe lidhjet apo komunikimet e kryeprokurores me kryeministrin Rama, sekretarin e tij Engjëll Agaçin, ministrin Xhafaj, apo avokatët dhe njerëzit e Shullazit. "Është po kaq urgjente nevoja për të verifikuar: Cilat janë lidhjet direkte apo indirekte të Arta Markut me Edi Ramën? Çfarë komunikimesh ka Arta Marku me Engjëll Agaçin dhe si kanë ndikuar ato në shkatërrimin e hetimeve për "Tahirin" dhe zvarritjen e çështjes "Shullazi"? Çfarë i kanë kërkuar kryeprokurores Fatmir Xhafaj, Ulsi Manja, Ermonela Felaj apo ndonjë deputet tjetër socialist? Hetimet duhet të qartësojnë a ka patur kryeprokuroria kontakte me avokatët apo të dërguar të Emiliano Shullazit"? u shpreh Alibeaj. Hetimi pa vonesë për padinë penale të opozitës dhe pezullimi i Arta Marku nga detyra, sipas Alibeajt është shërbimi më i madh që prokurorët e ndershëm mund t'i bëjnë drejtësisë





Kryetarja e LSI-së: Gjueti shtrigash, Marku s'mund të caktojë prokurorë për dosjet

"Bajret", Kryemadhi: Bushati i ka pasur truproja në fushatë

"Edi Rama nuk do të jetë më kryeministër në qershor"

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika Kryemadhi akuzoi dje, ministrin e Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati se ka pasur truproja të veta anëtarë të bandës së Bajret në Shkodër. Në emisionin "Kjo Javë" me Nisida Tufën në "News24", Kryemadhi tha se këta persona, Ditmir Bushati i ka patur badigardët e vet në fushatën elektorale për zgjedhjet e përgjithshme të 2017. "Ne gjithmonë e inkurajojmë dhe suportojmë Policinë e Shtetit, ne nuk suportojmë inkriminimin e policisë. Shpresoj që të jetë një aksion, siç është në të vërtetë në bashkëpunim me ndërkombëtarët, dhe të ketë rezultat. Mendoj se është shumë e rëndësishme sa është i lidhur Rama me këtë bandë, sa është i lidhur Bushati, dhe ndikimi në zgjedhjet e kaluara. Deri ku shtrihen falangat e tyre. Nuk është problemi se arrestohen 11 burra, por sa është i shtrirë ndikimi i tyre. Bushati i ka pasur badigardët e vet në fushatë elektorale, e dimë shumë mirë si terrorizoheshin njerëzit në fushatë", tha kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së, Kryemadhi ka folur për aktualitetin politik si dhe ngërçin me Prokurorinë e Krimeve të Rënda, pasi ndaj 10 prokurorëve nisi procedim disiplinor, sepse refuzuan shortin për çështjen Shullazi. Kryemadhi tha se Arta Marku nuk mund të caktojë prokurorë për dosjet, pasi kjo bëhet me short. "Mënyra si u zgjodh prokurorja kështu do ndodhte. Nuk kam asnjë dilemë se do shkonim drejt shkurirjes së prokurorisë. Sepse synim mbetet mbijllja e hetimeve për Shullazin dhe Tahirin. Ne nuk mendonim se do shkonim kaq larg, por me bekimin e EURALIUS tregon se krimi i organizuar i ka shtrirë tentakulat deri në institucionet ndërkombëtare. Pra, prokurorja e zgjedhur me 69 vota ia imponoi shqiptarëve këtë prokurorë. Ne nuk mendonim se papërgjegjshmëria e tyre do arrinte në këtë fazë. Ne kemi bërë padi ndaj Arta



LULZIM BASHA
Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha deklaroi dje, se kryeministri Edi Rama është kundër vetëingut në politikë, nismë kjo e iniciuar nga selia blu. Përmes një reagoni në "Twitter" Basha shkroi: "Më në fund e pranoi: ai është kundër vetëingut në politikë, është kundër pastrimit të politikës nga krimi. Të tjerat janë llogje. Por pyetja mbetet: pse e ka frikë Edi Rama vetëingut e politikës?"

Markut dhe ne do depozitojmë çdo padi. Për mua gjuetia e shtrigave ndaj prokurorëve ka qenë shantazhuese që të asimiloheshin pushteti i tyre në duar të Edi Ramës. Prokurorja nuk ka kompetencë për të caktuar prokurorë për dosjet, pasi kjo bëhet me short. Kapja e reformës në drejtësi nuk sjell gjë tjetër vetëm pasiguri tek shqiptarët"- tha Kryemadhi.

OPOZITA

E pyetur nëse LSI do hyjë në zgjedhje me Ramën kryeministër, Kryemadhi tha se ai nuk do jetë deri në qershor kryeministër, por nuk e ka specifikuar sesi do ikë kryeministri. "Nesot nuk jemi në një situatë normale që luan me rregullat e lojës. Sot nuk diskutohet çfarë do marrë PD apo LSI në zgjedhje. Opozita duhet të krehë këtë qeveri që është bërë e rrezikshme për shqiptarët dhe po bëhet element i

rrezikshëm dhe për rajonin. Për ne nuk ka rëndësi numri i bashkëve, por të mos ketë deformim të votës. Pjesa tjetër është e shqiptarëve që u takon të zgjedhin kandidatët. Unë mendoj se Rama nuk do jetë deri në qershor kryeministër, atëherë kur do zhvillohen zgjedhjet lokale. Rama edhe mund të çmendet. Vetëingut në politikë është i rëndësishëm dhe më pas vijin hapat e tjera"- tha Kryemadhi.

Kreu i Grupit të LSI sulmon kryeprokuroren

Petrit Vasili: Arta Marku e inkriminuar, nuk po heton Ramën

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së Petrit Vasili ka sulmuar ashpër kryeprokuroren Arta Marku lidhur me lëvizjet që kanë ndodhur këto ditë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Përmes një statusi në Facebook Vasili e cilësoi Markun si "mashë" të kryeministrit Rama. Sipas Vasilit, dosja e dhunimit të detyrës të Arta Markut po rritet me shpejtësi marramendëse. "Arta Marku me vetëdijen e kamikazes po shfaqet hapur një mashë e kryeministrit duke mos e hetuar atë, duke mos e pyetur dhe duke mos e marrë të pandehur. Që në 11 korrik kryeministri është i paditur në prokurori, sepse mashtrioi publikisht popullin shqiptar lidhur me audiopërgjimin e vëllait të ministrit të Brendshëm kur ai vetë përpara Grupit Parlamentar të PS deklaroi publikisht: "Kam marrë mbrojtje përgjigjen e analizës shkencore nga një prej laboratorëve më të mirë në botë. Ajo provë më mjafton për t'ju thënë juve se nuk jemi përpara një prove kompromentuese ndaj ministrit. Jemi përpara një materiali jo autotenik që synon destabilizimin", shkroi dje, Vasili. "Dosja e dhunimit të detyrës të Arta Markut po rritet me shpejtësi marramendëse dhe ajo pandeh se ky kryeministër do t'i dalë në krah në ditën e saj të hallit. Sa naive e shkreta...Nuk e di që do të jetë thjesht një kufomë më shumë në listën e skelleve në sirtarin kryeministrit të kapur nga krimi"-u shpreh Vasili.



Kryemadhi: Xhika u godit politikisht, PS nuk parashikoi rritjen e LSI në 2017

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, lajmëroi strukturën e saj në Elbasan se opozita nuk ka marrëdhënie me parlamentin pasi ky institucion është braktisur nga qeveria. "Tashmë marrëdhënia e opozitës me parlamentin e Edi Ramës nuk ka më asnjë lloj kuptimi. Nuk është opozita ajo që e bojkotuar parlamentin, por është maxhoranca ajo që ka bojkotuar parlamentin. E ka bojkotuar parlamentin për sa i përket të gjithë angazhimit të saj në marrëdhënie me qytetarët", u shpreh Kryemadhi. Duke folur për rritjen e simpatizantëve të LSI, Kryemadhi tha se goditja e kësaj partie nga qeveria Rama është e lartë dhe shembull për këtë është ish-kreu i AARRS-së, Dashamir Xhika,



për të cilin kryetarja e LSI-së është e bindur se u godit politikisht. "Arrestimi i Dashamir Xhikës është një goditje që bëhet për LSI-në e Elbasanit, duke pasur parasysh që struktura e LSI-së së Elbasanit është një strukturë që i doli jashtë parashikimeve Partisë

Socialiste në zgjedhjet e 2017", tha Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së tha se LSI do të bashkëpunojë në Elbasan me PD dhe PDIU që iu bashkë së fundmi opozitës për të zhvilluar një axhendë të përbashkët aksionit opozitar.

Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit notarial kombëtar për verien në funksionin të databazës shtetërore NISA, Dhoma Kombëtare e Noterisë (DH.K.N.) Ikon Operatore Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë. Dokumentat e projektit mund të terhiqen përkundërt pageses prej **10.000 leke**, prane DH.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tiranë, Shqipëri. Propozimet do të pranohen brenda datës **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

Zyra e Përmbartimit Albuis, me përmbartues gjyqësor privat Zef Macaj, në bazë të vendimit nr. 1857, datë 19 Shtator 2018, shpall shiten në ankand të pasurisë pasurisë "Nderëtes", me sipërfaqe 115 m², me numër pasurie 6/596/ND, volumni 37, faqe 111, zona kadastrale nr. 8120, me adresë: Rr. "Niko Avrami", Tiranë, në vlerën 43, 361.6 (dyzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një, pikë gjashtë) Euro. Ankandi zhvillohet në ambjentet e Zyrës të Përmbartimit Albuis, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nderëtes nr. 6, Hyrja nr. 3, Apartamenti nr. 8, Njësia Administrative nr. 10, 1001, Tiranë, ditën e Enjte, me datë 19 Shtator 2018, ora 16.15.

STUDIO PËRMBARTORE GJYQËSORE "KREONI" ME PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA Dt. 25.09.2018 ora 16:00 Përfundon Ankandi i Parë për pasuritë: - Pasuria "Lokali nr.4" me sip.66 m², me adresë L.13, Plazh Durrës. Me çmim 66 000 Euro - Pasuria "Lokali nr.5" me sip.43 m², me adresë L.13, Plazh Durrës Me çmim 51 600 Euro -Pasuria "Lokali nr.6" me sip.110 m², me adresë L.13, Plazh Durrës Me çmim 140 800 Euro Ankandi zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARTORE GJYQËSORE "KREONI", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma Iliria),Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682906575

'Albanian Lion 2018', Xhaçka: Stërvitja më e madhe e vitit**Ushtritë e 4 vendeve, stërvitje në sheshin 'Nënë Tereza', pjesë edhe Kosova**

Rreth 1200 ushtarë nga Britania e Madhe, Kroacia, Kosova dhe Forcat e Armatosura shqiptare, do të zbrisin të hënën, në sheshin "Nënë Tereza" për të nisur stërvitjen më të madhe të vitit e quajtur "Albanian Lion 2018". Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, përmes një postimi në rrjetet sociale të bëhen pjesë e kësaj stërvitjeje ushtarake. "Mbi 1 mijë ushtarakë shqiptarë dhe britanikë zbrisin të hënën në sheshin "Nënë Tereza". Ejani me 24 shtator ora 11:00, të jeni pjesë e stërvitjes ushtarake më të madhe të vitit. Albanian-Lion2018". 80 efektivë dhe

4 anije të Forcës Detare shqiptare prej më shumë se një jave janë angazhuar në stërvitjen e përbashkët "Albanian Lion 2018", shkroi dje, ministria. Stërvitja "Albanian Lion 2018", e cila po zhvillohet në vendin tonë me pjesëmarrjen e forcave ushtarake nga Britania e Madhe, Kroacia, Kosova dhe Shqipëria, po praktikon elementë stërvitorë të ndryshëm, duke përdorur edhe rajonet stërvitore të Forcës Detare. Në Gjirin e Dukatit në Vlorë, po zhvillohen stërvitje të trupave me pjesëmarrjen e palombarëve anglezë, kroatë dhe shqiptarë. Ndër elementët stërvitorë kryesorë të tyre janë kërkimi nënujor, gjetja e objekteve të ndryshme, nxjerrja e tyre në sipërfaqe, kërkime rrethore etj. Në stërvitjen zhytëse marrin pjesë mjete lundrimi të tre vendeve: Britanisë së Madhe, Kroacisë dhe Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, nga Kepi i Palit deri në Porto Palermo, Forca Detare me katër anije dhe një grup bordingu po zhvillon stërvitje detare me anijen britanike "RFA Lyme Bay" dhe një he-

likopter "Wildcat" duke ekzekutuar elementë të ndryshëm stërvitorë si mbrojtje e afërt dhe largët, operacion zbarkimi trupash, mbrojtjen e anijes komandë nga sulme të befasishme etj. Stërvitja "Albanian Lion 2018" po zhvillohet njëkohësisht në disa garnizone të FA si në Durrës, Pashaliman, Porto - Palermo, Rinas, Zall-Herr dhe Bizë me pjesëmarrjen e 1164 trupave ushtarake, 126 mjeteve tokësore, detare, ajrore dhe ka për qëllim realizimin e operacioneve të ndryshme

nëpërmjet tokës, detit dhe ajrit. Ndërkohë, ditën e hënë, më datë 24 shtator, ora 11:00 do të zhvillohet në sheshin "Nënë Tereza" në



Tiranë. Dita e Vizitorëve të Shquar të kësaj stërvitjeje, ku pritet të marrë pjesë kryeministri Edi Rama.

Ministri i Financave i përgjigjet PD: 97% e shqiptarëve sot paguajnë më pak

TIRANE

Ministri i Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj i është përgjigjur dje përmes një postimi në Facebook deklaratisë së sotme të Partisë Demokratike lidhur me sistemin e monitorimit të transaksioneve të biznesit. Ahmetaj u shpreh se nuk do ketë asnjë kosto shtesë për bizneset.

DEKLARATA E PLOTE

"Jam i habitur me zonjën Tabaku dhe bashkëpunëtorin X të saj, që sot dolën në një duet përçarjeje publike për sistemin e ri të monitorimit të transaksioneve të biznesit. Përtej gjithë ç'kanë thënë, për turpin e tyre, dua të nënvizoj: Sistemi nuk do të ketë asnjë kosto shtesë për biznesin. Përkundrazi, do të ulë kostot e rënda të sistemit aktual që kemi trashëguar nga koha kur partia e zonjës Tabaku dhe bashkëpunëtorit X të saj, imponoi kasa me kosto të paktën 300 euro vetëm për instalimin dhe që e kanë mirëmbajtur më të shtrenjtë se të veturave, por që sidoqoftë nuk do të jetë aspak kusht që të dalin nga funksioni.

PËR QYTETARËT:

1- Me procedurën e re të shpallur, synohet ndërtimi i një sistemi monitorimi transaksionesh, i cili do të ndërveprojë me sistemin aktual c@ts (pra, sistemi i administrimit të taksave që përdor çdo tatimpagues, i prokuruar nga qeveria e Partisë Demokratike në vitin 2013 me vlerë mbi 10 milionë euro) si dhe krijimit për herë të parë të komunikimit në kohë reale si të transaksioneve ndërmytë biznesit dhe konsumatorit, ashtu edhe të biznesit me biznesin.

2- Ndërsa tre vjet më parë, administrata tatimore ishte e fokusuar në implementimin e sistemit E-tax, sot po kalon në nivelin tjetër të administrimit dhe luftës kundër informalitetit, betejë e cila kërkon modernizimin e sistemit dhe përdorimin e instrumenteve

Ahmetaj: Monitorim transaksioneve, pa asnjë kosto shtesë për biznesin

"Sot mbi 91% e bizneseve e kanë tatimfitimin 0 ose 5%"



Ministri i Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj

DEKLARATA E JORIDA TABAKUT

Dy deputetët e PD, Jorida Tabaku dhe Endri Hasa nga selia blu akuzuan qeverinë "Rama" lidhur me tenderin për monitorimin online të bizneseve. Sipas PD-së qeveria bëri disa kritere ekskluzive që të fitonte kompania e paracaktuar në sistemin e taksave. Deputetja Tabaku tha se kjo garë ishte farsë.

të reja, inteligjente, për të rritur efikasitetin.

3- Në të njëjtën kohë, ky sistem mundëson një informacion më të qartë dhe në kohë për vetë biznesin, për transaksionet e deklaruara të tij me çdo biznes tjetër.

4- Procedura konkurruese në fjalë dhe kriteret e saj, janë përgatitur dhe shpallur nga Agjencia Kombëtare e Shqipërisë së Informacionit, agjencia me ekspertizën më të lartë për sistemet informa-

tive në sektorin publik dhe për rrjedhojë, mbetet pronësi e vetë shtetit shqiptar dhe aspak koncesion i një kompanie private, aq më pak koncesion për TVSh apo absurd i dhënies së të drejtave ekskluzive për ndryshimin e ligjeve të shtetit shqiptar.

5- Sa i takon kostovet imagjinare prej 600-1000 euro për çdo biznes, apo 80-100 milionë euro në total, theksojmë sistemi i ri nuk do të ketë asnjë kosto shtesë për biznes-

in; kasat aktuale nuk do të dalin jashtë përdorimit, por do të përditësohen me sistemin e ri duke ofruar opsione për sipërmarrjen, pa kosto.

Sot, 97% e shqiptarëve të punësuar paguajnë rreth 120 milionë dollarë në vit më pak taksa, falë taksimit progresiv. Në 4 vjet, i kemi kthyer mbrapsht qytetarëve në xhepat e tyre 500 milionë dollarë që Partia Demokratike ua vidhte me taksën e sheshtë.

Sot, mbi 91% e bizneseve e kanë tatimfitimin 0 ose 5%, pra 100% ose 50% më pak se në kohën e PD. Vetëm me këtë ulje, i kemi kursyer biznesit 23 milionë dollarë në vit, që Partia Demokratike ua merrte si taksa në buxhetin e shtetit", deklaroi Ahmetaj.

Presidenti diskutim për sigurinë**Meta nis për në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork**

Presidenti i Republikës, Ilir Meta u nis drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të marrë pjesë në Sesionin e 73-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që do të zhvillohet në Nju-Jork.

Kryetarët e shteteve dhe qeverive pjesëmarrës në këtë veprimtarë të rëndësishme e të përvitshme botërore do të diskutojnë rreth çështjeve dhe problemeve të ndryshme që kanë lidhje me paqen dhe sigurinë globale, të drejtat e njeriut dhe kontributit e përgjegjësisë kolektive të OKB-së në ndërtimin e shoqërive paqësore dhe të drejta. Kreu i Shtetit shqiptar do të mbajë një fjalim në debatin e përgjithshëm të Sesionit të 73-të, duke iu drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Gjatë vizitës zyrtare në Nju-Jork, Presidenti i Republikës do të zhvillojë takime dypalëshe me homologët e ndryshëm, me zyrat e lartë të qeverisë amerikane edhe me përfaqësues e anëtarë të shumtë të bashkësisë shqiptaro-amerikane që jetojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Gati projektvendimi për kufizimin e importit të mjeteve mbi 10 vjet të përdorura

Nga 1 janari ndalohet importi i makinave prodhim para 2009

Klosi: Çdo ndodhë më 60 mijë makinat e futura rishtazi

Ornela Manjani

Duke nisur nga data 1 janar 2019, në Shqipëri do të ndalohet importi i makinave të përdorura mbi 10 vjet prodhim. Në ditën pa makina, ministri i Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi ka prezantuar këtë projektvendim. Sipas ministrit projektvendimi nuk prek makinat e përdorura mbi 10 vjet prodhim që janë aktualisht në qarkullim, por kufizon futjen e makinave të tilla pas 1 janarit 2019. Ndërsa për makinat e patarguara që janë aktualisht në Shqipëri do të lihet një afat 5 muaj që të regjistrohen. Ministri Klosi theksoi se kjo nismë bëhet në mbështetje të shëndetit të qytetarëve, pavarësisht kundërshtimit nga grupe të caktuara interesi si komuniteti i menaxhimit të biznesit, ata që merren me riparimin e makinave të vjetra dhe shitësit e karburantit. "Në radhë të parë ne flasim për shëndetin dhe kur bëhet biseda për shëndetin nuk ka nevojë që të bësh asnjë bisedë tjetër, kur flitet sesa shumë janë shtuar problematikat e sëmundjeve në vetëm vitet e fundit në vendin tonë që vijnë nga ndotja e ajrit, nga makinat në vendin tonë. Nga viti 2012 në 2015 sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë në kemi 23% më shumë sëmundje të njerëzve nga ndotja. Dhe për këtë ne du-



Ministri i Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi

het të marrim veprime drastike për të kufizuar ndotësit dhe prandaj marrim këtë mekanizëm drastik, sepse duam që të reduktojmë në maksimum ndotjen e ajrit", deklaroi ministri. Klosi dha shembullin e Kosovës, si një ndër vendet që e ka futur

këtë kufizim. Sipas të dhënave, masha mesatare e makinave në Shqipëri është 20 vjet, çka shton kostot e mirëmbajtjes dhe të karburantit. "Në qoftë se një qytetar kërkon të blejë një makinë, me ato pak lek që ka, të mos blejë një makinë

me emër të madh që ka bërë 200 mijë km, që konsumon karburant 5 herë më shumë, që për dy vjet e çon për skrap, por të përqipet të ketë një makinë të normave me kapacitet më të vogël, me po ato para që ta mbajë 7-8 vjet, të konsumojë çdo ditë 1 të

DY NDRYSHIMET

E para është ndalimi i importit të makinave të vjetra mbi 10 vjet. E dyta dytë është ulja e TVSH-së për automjetet e reja në 10% nga 20% që është aktualisht, duke i bërë ato më të lira.

trëten e karburanti dhe në fund atë makinë edhe e tregon", tha Klosi. Ministri u kërkoi ndërkohë koncesionarëve të makinave që të orientojnë tregun me makina më të përshtatshme edhe në çmim, për qytetarët e thjeshtë.

ULJA E TVSH-SË

Në ditën pa makina, ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, ka bërë të ditur gjatë një takimi me

distributorët e automjeteve projektligji ka dy pika kryesore. E para është ndalimi i importit të makinave të vjetra mbi 10 vjet. Elementi i dytë është ulja e TVSH-së për automjetet e reja në 10% nga 20% që është aktualisht, duke i bërë ato më të lira. Klosi tha se kjo masë merret për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e banorëve dhe synon edhe reduktimin e ndotjes që shkaktohet nga karburantet. Klosi tha se makinat e vjetra që qarkullojnë sot nuk do të dalin nga tregu, por do u jepet kohë që të përshtaten. E njëjta gjë do të bëhet edhe për automjetet që janë importuar dhe që janë stok, pra nuk janë targuar akoma. Klosi tha se janë rreth 60 mijë automjetet të tilla, të cilave do u jepet një afat prej 4-5 muaj që të targojnë. Nisma e fundit e qeverisë gjeti dhe mbështetjen e distributorëve, të cilët e cilësuar një hap në drejtimin e duhur.

Ndryshon financimi në bujqësi

Investimet në agroturizëm, parapagesë në masën 30 për qind të vlerës

Ministria e Bujqësisë ka ndryshuar mënyrën e mbështetjes financiare për fermerët, për të bërë të mundur që fondet e vëna në dispozicion të përthithen më lehtë. Kështu, më parë skema ka qenë e tillë, që përfituesit e projekteve, duhet të bënin më parë investimin dhe më pas të përfitonin në formë granti deri në 70 për qind të financimit, duke vënë në vështirësi financiare sipërmarrësit në bujqësi apo fermerët, gjë që jo rrallë herë përfundonte në mrosrealizim të projektit. Tashmë, me vendim qeverie, aplikuesve që shpallen fitues me planet e tyre të biznesit, pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht 30% e masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së parapagesë, të lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka, si dhe situacione pjesore të punimeve të kryera dhe/ose blerje të makinerive dhe pajisjeve, të vërtetuara



kundrejt dokumentacionit përkatës. Kjo lehtësi është bërë për disa kategori aplikuesish, si për mbjelljet e mollës, arrorëve, qershive, lajhive dhe gështenjave si dhe për instalimin e bankinave lundruese. Nga kjo lehtësi përfitojnë, gjithashtu, kategoritë që ka të bëjë me diversifikimin ekonomik në zonat rurale, pra investimet e ndryshme në agroturizëm dhe start-upet në këtë fushë. Sipas skemës së miratuar nga qeveria shteti shqiptar do të shpërndajë 2.56 miliardë lekë në grante për të mbështetur bujqësinë dhe zhvillimin rural. Skema e re përfshin mundë-

si financimi që nga mbjelljet e reja e deri tek investimet në serra, teknikat e ujitjes, shtimin e kafshëve, blerjen e makinerive e deri te hapja e dyqaneve për të tregtuar produkte vendi. Ministria e Bujqësisë ka përgatitur një "skemë" dhe fondet për secilën pikë të saj do të jenë të kufizuara, në mënyrë që fermerët të diversifikojnë produktin dhe investimet në bazë të nevojave të vendit. Në këtë rast, aplikimi për një nga skemat që ka fondin më të madh, i jep fermerit shansin më të lartë për të përfituar.

Obligacionet 5-vjeçare të qeverisë

Interesat pësojnë përsëri rënie në ankandin e fundit

Interesat e obligacioneve 5-vjeçare të qeverisë shqiptare ranë përsëri në ankandin zhvilluar këtë javë. Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, obligacionet u emetuan me një yield mesatar prej 4.74%, në rënie prej nivelit 4.86% të ankandit pararendës në muajin gusht. Rënia e mëtejshme e interesave të borxhit qeveritar dëshmon një treg që ngelet i stabilizuar dhe mjaft likuid. Sinjalet dhe orientimet e dhëna nga Banka e Shqipërisë në politikën monetare po përcillen më së miri në tregjet financiare. Në mesin e këtij viti, Banka qendrore thelloi kursin stimulues të politikës monetare, përmes uljes së normës bazë të interesit në minimumin e ri historik prej 1%. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës parajaljmëroi se nuk pritet të ketë rritje të interesave të paktën



deri në mesin e vitit të ardhshëm. Nga ana tjetër, presionet e pakta mbi likuiditetin e sistemit financiar e favorizojnë transmetimin e kësaj politike. Kreditimi i ekonomisë ngelet në stanjacion dhe vlera e portofolit është afërsisht në nivelet e vitit 2011. Në kushtet kur tregu i kredisë

për sektorin privat nuk po tërheq më shumë financime, kërkesa e institucioneve financiare për titujt qeveritarë ngelet e lartë. Nga dy miliardë lekë obligacione të shpallura për shitje nga Ministria e Financave, shuma e kërkuar arriti në pothuajse katër miliardë lekë.

DYSHIMET



BULQIZË - Një grabitje me armë ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në Qytetin e Ri në Bulqizë. Sipas të dhënave pre e grabitësve ka rënë banesa e familjes Mira. Menjëherë pas ngjarjes Policia e Bulqizës kanë shoqëruar 8 persona dhe kanë shpallur në kërkim një nga autorët e dyshuar të ngjarjes. Një grup i posaçëm hetimor nga Drejtoria Ven-

dore e Policisë Dibrë me në krye drejtorin e policisë Etmond Tarkaj po kryen veprimet për zbardhjen e ngjarjes.

Kryefamiljari Ahmet Mira, 50 vjeç ka rrëfyer ngjarjen për policinë.

Ai ka thënë se tre persona të maskuar kanë grabitur dhe i kanë dhunuar bashkë me gruan 37 vjeçe.

Policia ka konstatuar nga veprimet e para hetim-

Grabitet dhe dhunohet çifti në Bulqizë, 8 të shoqëruar

more se tre persona të maskuar që dyshohet se posedonin dhe armë zjarri, i kanë futur në banesë, kanë kontrolluar për sende me vlerë, dhe më pas janë larguar duke marrë automjetin tip "Benz" në pronësi

të shtetasit A.M. Mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative shërbimet e policisë kanë shoqëruar si të dyshuar për ngjarjen 8 shtetas, si dhe është shpallur në kërkim një shtetas tjetër, si

një ndër autorët e dyshuar të kësaj ngjarje ku për arsye hetimi nuk bëjmë me dije të dhëna të tjera. Po në vijim të punës për zbardhjen e kësaj ngjarje shërbimet e policisë kanë bërë të mundur gjetjen e automjetit, të braktisur. Vijojnë hetimet për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes.

Lihet i lirë, 'Procedim penal' për "drejtim mjeti në mënyrë të parregullt"

Piloti i dehur, policia kufitare bllokoi fluturimin nga Rinasi

47-vjeçari nga Spanja ishte i alkoolizuar

Policia Kufitare e Rinasit bën me dije se ka bllokoi fluturimin e një avioni, pasi piloti kishte konsumuar alkool. Sipas policisë është proceduar penalisht në gjendje të lirë piloti spanjoll E. L., 47 vjeç. Mësohet se në kohën kur pasagjerët kanë hipur në avion, një koleg i pilotit të alkoolizuar ka njoftuar Policinë Kufitare të Rinasit se kolegu i tij me shtetësi spanjolle kishte konsumuar alkool. Policia Kufitare ka ndërhyrë menjëherë duke bllokoi fluturimin dhe ka kthyer pasagjerët në transit.

NJOFTIMI I POLICISË

Bllokohet nga Policia Kufitare fluturimi i një avioni, pasi kapiteni kishte konsumuar alkool.

Procedohet penalisht në gjendje të lirë shtetasi spanjoll E. L., 47 vjeç.

Shtetasi E. L., është kapiteni dhe në kohën që pasagjerët kanë qenë duke hipur në avion kolegu i tij ka njoftuar Policinë Kufitare të Rinasit dhe kompaninë që kapiteni ka konsumuar alkool në masë të madhe.

Policia Kufitare ka ndërhyrë menjëherë duke bllokoi fluturimin dhe ka kthyer pasagjerët në transit.

Shtetasi E. L., pas kërkesës së kompanisë ajrore i është bërë testi i alkoolit dhe nga bërja e testit të alkoolit kapiteni ka rezultuar



pozitiv, pasi kishte konsumuar alkool në masën 0.35 mg/l testi i parë dhe 0.31mg/l testi i dytë.

Për sa më sipër pas konsultës me Prokurorin, shtetasi E. L. u procedua penal-

isht në gjendje të lirë dhe materialet ju referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprime të mëtejshme për veprën penale "Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt".

Kompania ka marrë masat duke zëvendësuar kapitenin (pilotin) me një tjetër dhe për këtë shkak është shtyrë fluturimi për 5 orë më vonë.

------	-------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	---------------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	-----	---------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	----------	--------------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	---------	-------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	-----------------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	-----------	----------	------	------------	-------	------	------	------	--------	----------	------	------------	-------	------	-----	---------	-------	----------	------	------------	-------	------	-----------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	--------	-----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	-----------	-------	----------	------	------------	-------	------	------	------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	---------	----------	----------	------	------------	-------	------	---------	---------	--------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	---------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	-------------	----------	------	------------	-------	------	------------	--------	---------	----------	------	------------	-------	------	----------	--------	---------	----------	------	------------	-------	------	-------	---------	------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	-------	------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	----------	--------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	------	---------	-------	----------	------	------------	-------	------	-------	------	------	----------	------	------------	-------	------	-----------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	--------	-----------	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	--------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	-----------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	------	----------	------	------------	-------	------	------	------	------	----------	------	------------	-------	------	------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	---------	-------	----------	------	------------	-------	------	-----	-------	---------------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	---------------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	----------	----------	------	------------	-------	------	---------	---------	--------	----------	------	------------	-------	------	--------	------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	-------------	----------	------	------------	-------	------	-------	---------	------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	-------	------	-------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	--------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	--------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	---------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	---------	----------	------	------------	-------	------	----------	--------	----------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	------------------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	-----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	-------	------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	---------------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	----------	----------	------	------------	-------	------	-------	--------	--------------	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	---------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	------	-----	-------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	--------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	------	----------	----------	------	------------	-------	------	------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	--------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	---------------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	----------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	---------	----------	------	------------	-------	------	-------	------	--------	----------	------	------------	-------	------	-----------	-------	---------	----------	------	------------	-------	------	-----------	-----	------	----------	------	------------	-------	------	------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	-------	---------	------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	-----------	---------	------------------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	-------	------	---------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	-------------	----------	------	------------	-------	------	----------	---------	----------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	---------------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	-----------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	-----------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	------------------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	---------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	------------	----------	------	------------	-------	------	--------	------	--------	----------	------	------------	-------	------	----------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	---------	----------	------	------------	-------	------	-------	--------	--------	----------	------	------------	-------	------	-------	--------	---------------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	---------	----------	------	------------	-------	------	---------	---------	----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	-----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	-------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	---------	---------------	----------	------	------------	-------	------	------	-----	----------	----------	------	------------	-------	------	------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	------	------	-----	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	-------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	-------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	-------	---------	------------------	----------	------	------------	-------	------	------	-------	-----------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	-------	----------	------	------------	-------	------	---------	---------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	----------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	---------	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	-----------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	---------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	----------	----------	-------------	----------	------	------------	-------	------	----------	--------	-----------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	-------	-------	--------------	----------	------	------------	-------	------	-----------	------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	---------	--------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	--------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	--------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	--------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	------	----------	----------	------	------------	-------	------	------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	---------	---------	---------	----------	------	------------	-------	------	---------	------	------	----------	------	------------	-------	------	-------	---------	------------	----------	------	------------	-------	------	--------	------------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	-----	------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	--------	----------	------	------------	-------	------	------	-----	----------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	------	----------	------	------------	-------	------	----------	---------	-----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	----------	----------	----------	------	------------	-------	------	---------	-------	-----------------	----------	------	------------	-------	------	---------	--------	-------	----------	------	------------	-------	------	----------	-------	-----------	----------

EKSPOZITA

LORI LAKO

Deti asht larg, por të kripun i kam lotët

Nga Adrian Paci*

Ka disa ditë që në galerinë e qytetit të Shkodrës, asht hap një ekspozitë që meriton vëmendje dhe shënon debutimin në skenën e artit shqiptar të artistes Lori Lako.

Lindun në Pogradec dhe e shkollueme në Firence, Lako vjen në këtë ekspozitë të parë personale me një timbë zani krejt të veçantë. Punimet e saj dallohen nga një vëmendje therëse e një ndjeshmëri e butë, e cila përvijon ndërhyrje ku thjeshtësia formale bashkëjeton me dendësinë konceptuale e ku kjo e fundit, nuk i mbivendoset punimeve nga jashtë, por buron prej tyre.

Ka gjithmonë diçka intime në punimet e Lori Lakos që ndeshet me një dimension ma të gjanë, herë të dominuem nga konturet gjeopolitike, herë nga ndërhyrjet teknologjike e herë nga të dyja bashkë.

Ky intimitet nuk bahet kurrë sentimental megjithëse dimension i afektiv rrin pezull mbi punët e artistes duke i dhanë formave në dukje minimale një vibracion prëkës. Në hymje të ekspozitës vizitori ndeshet me një katror të kaltër e transparent, në thellësi të cilit shfaqen lehtës disa linja që syni mezi i kap. Duhet të afrohes me kujdes që aty të dallosh përvijimet gjeografike të globit që e ka rumbë dimensionin e tij të rrumbullakët për të na u paraqitë në formën konvencionale të një harte. Konturet e ravijëzimeve gjeografike janë zhytë nën peshën transparente të kaltërsisë që sugjeron një unifikim të mundshëm apo një rifillim biblik, ku çdo gja dremitet nën ujë.

Ma tej, ekspozita zhvillohet në dy hapsina ku nga njena anë qëndrojnë disa punime video, e nga ana tjetër foto e vizatime.

You can't go green asht titulli i videos që na del përpara sapo futemi në sallën e errët. Një fushë e gjelbër dhe e pikselueme asht protagoniste. Syni rrëshqet në sipërfaqen e blertë e herë mbas here hapsina e ekranit konturohet nga linja të bardha që na flasin për një fushë futboll. Jena në prani të një ndeshjeje ku dy skuadra me flamur e me himne të ndryshme përballen me njena-tjetren, në luftën se kush do ta fusë topin e rrumbullakët në rrjetën e tjetrës. E gjitha kjo veçse mbetet e padukshme. Syni i Lakos shman gjithçka që ka lidhje me agonizmin sportiv dhe ndjek me ngulm obsesiv ato pjesë të fushës ku mungojnë lojtarët apo topi. Përjashtimi i skuadrave, tifozërisë dhe topit, i jep

Është çelur më 14 shtator në Galerinë e Arteve të qytetit të Shkodrës ekspozita personale e artistes Lori Lako me titull: "THE SEA IS FAR, THOUGH MY TEARS ARE SALT". Ekspozita u mbështet nga Bashkia e Shkodrës, në kuadër të përkrahjes së projekteve institucionale që nxisin dhe promovojnë krijuesit e rinj në fushën e artit e të kulturës. Ajo do të qëndrojë e hapur për publikun deri më 14 tetor. Si fituese e çmimit "Idromeno" vitin e kaluar,

artistja Lori Lako vjen para publikut me një sërë punësh që krijojnë një panoramë me të plotë të stilit dhe botëkuptimit të saj artistik. Ekspozita përkoj me pjesëmarrjen e saj në "Art House School". Artikulli i mëposhtëm që po boton "Gazeta Shqiptare" është një kontribut i Adrian Pacit, artist i skenës ndërkombëtare të artit, pedagog në Venecia dhe themelues i "Art House" në Shkodër.



Lori Lako



Dy projeksione rrinë krah njëri-tjetrit në mur, e para nesh shfaqen dy trupa që janë shtri e po flenë. Janë një djalë e një vajzë. Gjithçka flet për një dimension të afërt e intim derisa nuk e kuptojmë se ajo që po shohim asht një filmim në skype dhe dy trupat gjenden larg njëri tjetrit. Videoja vazhdon kështu e

gjatë e monotone, si vetë gjumi i tyne. Nuk ka dialogje, buzëqeshje, kryqëzim vështrimesh apo gjeje afektive. Megjithatë ka diçka që ta ngacmon vazhdimisht fantazinë mbi një mardhanie të mundshme e cila mbetet peng i largësisë po aq sa edhe aktualizohet nëpërmjet imazheve të videos. Jo vetem dy trupat janë larg njëri-tjetrit, por edhe artistja nuk asht aty duke i filmue me kameran e saj siç pat ba dikur Andy Warhol kur filmonte "The Sleep". Synin dhe prezencën e artistit, tashti e zëvendëson kamera e kompjuterit dhe një file video që dërgohet me google drive. Google i vjen në ndihmë artistes edhe për realizimin e fotografisë *SH64*. Romanticizmi i skenës, ku buzë liqenit një çift të moshuemish shëtisin në prezencën e një karroce,



Lori LAKO (Pogradec, Shqipëri, 1991) jeton dhe punon në Firence, Itali. Ka kryer studimet në Akademinë e Arteve në Firence dhe një eksperimentë simestrale në Akademinë e Arteve në Mynih. Me anë të punës të saj artistike reflekton mbi gjendjen e njeriut postmodern, në një botë të shpejtë, mes një morie imazhesh e informacionesh që i vështirësojnë kujtesën historike dhe kërkimin e vetvetes.

JETËSHKRIMI ARTISTES

Prej këtu lind nevoja e krijimit si një proces kontemplativ që shpesh sjell në sipërfaqe dimensionin poetik të të qënurit. Ndër ekspozitat ku ka marrë pjesë veçojmë: Polis BBQ, Arte fier (Bologna 2018); Fituese e çmimit kombëtar për artin bashkëkohor "Idromeno", Galeria e Arteve (Shkodër 2017); Di queste luci si servirà la notte, Le Murate / Projekte për Artin Bashkëkohor (Firence

2017); TU 35 Expanded, Qendra për Artin Bashkëkohor Luigi Pecci (Prato 2017); Downside-up, Tirana Art Lab (Tiranë 2016); Era pacifica pare, Careof (Milano 2016); Jahresausstellung, Akademie e Arteve, (Mynih 2015); Nuovo cinema Masaccio, Casa Masaccio, (San Xhovani Valdarno 2014). Këtë vit ajo ishte njëra ndër artistet e përzgjedhur për Art House School në Shkodër.

ndeshet me informacionin e ftohtë e të depersonalizuem që vjen nga website. Kush janë këto dy njerëz? Cila asht historia e tyre? Si e përtojnë ato mardhanien me një-tjetrin e me peizazhin që i rrethon? Pyetjet ngelin pa përgjigje sa do që informacioni i përftuem nga teknologjia kërkon me deshifruje çdo element për bamës të imazhit, duke depërtue në skutat ma të imta të realitetit e duke e transformue atë në një furnizues të dhanash e algoritmesh. E njëjta dinamikë, ndonëse me mjete të tjera, na vjen në seritë e fotografive *Possibly may be*. Gjurmët e kalimeve të avionëve në një qiell të kalter ku brithtësia e shenjës koinçidon me poezinë e një fantazie të mundun që i mveshet çdo udhëtimi, shoqohen me informacionin e ftohtë mbi pikënisjet dhe destinacionet si për me dashtë me ngërthye përfundimisht në një të dhanë preçize atë që shenjat e dritshme e ofrojnë vetëm si sugjerim.

Takimi problematik, por aspak ballor, mes intimitetit dhe pushtetit i jep formë një tjetër fotografie; *Never great*, ku flamuri i një kombi të fuqishëm dhe fotografia e presidentit të tij gjenden në hapsinën e vogël të një dyqani berberi të fotografuem mbas xhamit reflektues së derës së mbyllun. Mbivendosjet që reflektimi paraqet shërbejnë edhe si sugjerime për shtrëzimet interpretuese që fotoja në thjeshtësinë e saj ofron.

Punimet e Lori Lakos shmanin çdo strukturë monumentale e çdo retorikë shprehëse. Ato mbesin të brishta e vibruese. E provokojnë mendimin pa u ba didaktike e pedante. Artistja nuk orvatet me formulue mesazhe të parapërgatituna e me ia paraqitë ato publikut, por ndan me ne një ndjenjë habie e mrekullimi të shqetësuem e shqetësues. Punët e saja nuk kërkojnë me marrë për dore shikuesin në një udhëtim të paracaktuem e as me e joshë me forma të bukura e sugjeshive, por synojnë me i sugjerue një mundësi leximi të botës ku e përditshmja dhe periferikja marrin vëmendje e ku ndjenjat tona nuk janë territore të ngrohta për kundjesh, por zona problematike të banueme nga tensione e konflikte të pashmangshme. Një vizatim i vogël në një letër kartoline të vjetër, por kurrë të dërgueme, na paraqet një fytyrë të brishtë nga ku një pikë loti rrjedh poshtë për t'u transformue në shprehjen që shoqon aq dendun spektaklin shumëgjyresh në të cilin jetojmë: Enjoy!

E DIEL

23 Shtator

2018



Kolë MACA

NGA QERIM VRIONI

Një nga fotografët më të shquar shqiptar të gjysmës së parë të shekullit të kaluar, mbetet pa dyshim Kolë Maca (1882-1945). Mësimet e para në lëm të “dhomës së errët”, ai i mori si të thuash *vjedhurazi* në studion e artistit dhe mjeshtrit shko dran, Kolë Idromeno, ku punoi qysh djalë i ri, si ndihmës (Sipas bisedës me piktorin Ndoc Gurashi, Shkodër, tetor 2012). Më pas, Maca ka thelluar njohuritë e tij mbi proceset fotografike në Austri (Gjithmonë sipas bisedës me N.Gurashin). Gjithsesi, shkruesi i këtyre radhëve ende nuk ka gjetur të dhëna të sakta mbi mënyrën e vajtjes, emrin e shkollës a kursit të fotografisë dhe kohëzgjatjes e studimeve të Kolë Macës në Austri.

Pas kthimit në atdhe nga Austria, ai hapi në Shkodër, në vitin 1910, në moshën 28-vjeçare, studion e tij fotografike, pa harruar të krijoj edhe vulën e tij të parë vetjake (të njomë) e cila do t’u vendosej mbrapa fotove të stampuara.

Por, para hapjes së studios dhe punës në të, Kolë Maca kishte arritur diçka krejt të veçantë, botimin në shtypin italian të kohës, pra mbi 100 vite më parë, dy artikuj mbi Shqipërinë të shoqëruar edhe me foto të tija të karakterit dokumentar, historik, etnografik, gjeografik, social etj. Ata, janë publikuar në faqet e “Revista Mensile del Corriere della Sera” (Revista e përmuajshme e Corriere della Sera) në Kol Mazza 1907:1 ago, fascicolo 8, dhe në Kol Mazza-1908: 1 mag, fascicolo 5, pra i pari në 1 gusht 1907 dhe i dyti në 1 maj 1908, në një largësi kohore prej 8 muajsh nga njeri-tjetri. Duhet shtuar se “Corriere della Sera”(Milano), qysh prej numrit të parë të saj, në vitin 1876, vazhdon ende sot të mbetet një nga gazetetat më serioze, më ndikuese dhe më jetëgjata në shtypin e shkruar në Itali (tashmë edhe në internet, online).

Artisti që u tregoi një shekull më parë italianëve, imazhin e shqiptarit

→ Vijnë në faqen 16



Ceremoni vdekjeje ndër shqiptarë

Redaktor: Ben Andoni. 354

**Në këtë numër: KURT GOSTENTSCHNIGG, REXHEP FERRI, QERIM VRIONI, STEVAN RAIÇKOVIQ }
ARDHUR NGA AGIM VINCA, SUL GRAGJEVI, ETJ...**

A

ARGUMENT

Shkrimi i parë i Macës titullohet “Tra i montanari albanesi” (Midis malësorve shqiptarë) i takon datës 1 gusht 1907 dhe shoqërohet me gjashtë foto bashkëngjitur me poshtë shënimet përkatëse. Natyrisht fotot e Macës ndihmojnë lexuesin italian për të perceptuar sa më mirë përmbajtjen e tekstit të shkruar. Aty shpalosen të dhëna etnografike, për traditat e popullit shqiptar, organizimin e jetës shoqërore, për bajraktarë dhe Kanunin e Lekë Dukagjinit, për dukurinë e gjakmarrjes, ceremonitë e martesave etj. Madje te njëra nga fotot paraqet një dasëm në veri të Shqipërisë, ndërsa një tjetër pasqyron një ceremoni vdekjeje sipas rriteve tradicionale të krahinës. Të dy këto foto më vonë u shtypën në Itali dhe qarkulluan si kartolina postare



Ura e Mesit



Dasëm (nusja) ndër shqiptarët e veriu

NGA QERIM VRIONI

Vijon nga faqja 13

Dy artikuj të Kolë Macës në shtypin italian

Shkrimi i parë i Macës titullohet “Tra i montanari albanesi” (Midis malësorve shqiptarë) i takon datës 1 gusht 1907 dhe shoqërohet me gjashtë foto bashkëngjitur me poshtë shënimet përkatëse. Natyrisht fotot e Macës ndihmojnë lexuesin italian për të perceptuar sa më mirë përmbajtjen e tekstit të shkruar. Aty shpalosen të dhëna etnografike, për traditat e popullit shqiptar, organizimin e jetës shoqërore, për bajraktarë dhe Kanunin e Lekë Dukagjinit, për dukurinë e gjakmarrjes, ceremonitë e martesave etj. Madje njëra nga fotot paraqet një dasëm në veri të Shqipërisë, ndërsa një tjetër pasqyron një ceremoni vdekjeje sipas rriteve tradicionale të krahinës. Të dy këto foto më vonë u shtypën në Itali dhe qarkulluan si kartolina postare

Në pjesën e artikullit që merret me ruajtjen e traditave të hershme nga popullsia shqiptare në vite, vend të veçantë në shkrim i jepet veshjes së tyre. Autori analizon mënyrën e .të veshurit të banorve të ndryshëm, të fshatit dhe qytetit, ndikimet nga lindja dhe



1 gusht 1907

nga perëndimi, me tendencë të zmadhimit të kësaj të dytës. Shkrimi nuk është i gjatë, rreth dy faqe, duke përfshirë brenda tyre edhe gjashtë fotot e autorit. Sidoqoftë, për një njëzetëepesë vjeçar siç ishte Maca në atë kohë, artikulli mund të vlerësohet si shumë i mirë, aq më tepër po të mendojmë (hamendje) se e ka shkruar vet në gjuhën italiane.

Në numrin e datës 1 maj 1908, sërish “Revista Mensile del Corriere della Sera”, publikon në faqet e saj shkrimin e dytë (mesa dijmë deri tani se mund të ketë edhe të tjerë) të fotografit Kolë Maca me titull “Monumenti e costumi albanesi” (Monumente



dhe kostume shqiptare), i shoqëruar edhe ky po me gjashtë foto të autorit. Imazhet fotografike të dalta nga objektivi i Macës, ashtu si edhe në artikullin e parë, ilustronë mirë përmbajtjen e materialeve shkrimore.



Grua myslimane në shtëpi dhe në rrugë



1 MAJ 1908



Në artikull paraqiten informacione të ndryshme me karakter gjeografik ndërthurur me mjaft kujdes dhe kulturë edhe me historinë dhe etnografinë e popullit dhe kombit shqiptar.

Ndër të tjera, në shkrim gjendet edhe fraza disi e guximshme dhe disi sfiduese se "Kur të gjithë tokat e Hungarisë, Serbisë, Bullgarisë filluan të nënshtrohen nga fuqia e Gjysëm-Hënës (Perandorisë osmaneshën.im) dhe së fundmi edhe Viena u kërcënu, Shqipëria e vetme ia ndaloi hapat dhe qëndroi i fortë para barbarëve (turqëve-shën.im). Madje, vazhdon, kjo tokë heronjsh dikur ishte **Muri Kinez** për turqit. Këto pohime, për luftat e Skënderbeut kundra pushtuesve otomanë, edhe me bazë krahasimin, tregojnë jo vetëm, njohtjen mirë nga Maca të historisë së Shqipërisë, dashurinë për atdheun e tij, por edhe theksimin e vlerave më të spikatura të saj për lexuesin Italian. Për veprën e Heroit tonë Kombëtar, Maca paraqet edhe disa cilësime sipërore të të huajve. Duhet shtuar se artikujt u shkruan në kohën (fillimi i shekullit XX), kur shqiptarët ndodheshin ende nën pushtimin osman, çka flet edhe për kurajon civile të fotografit.

Më poshtë, në shkrim flitet edhe për kështjellën simbol të Shkodrës me emrin *Rozafa*, origjinën e emrit, historinë dhe legjendën e saj tepër të veçantë, si dhe vendin që zë ajo kulturën shqiptare. Maca e shpjegon legjendën e Rozafës, bash ashtu si paraqitet edhe sot e gjithë ditës, në Shqipëri e kudo në botë, nëpër libra dhe botime të tjera me karakter historik dhe antropologjik.

Artikulli më poshtë, jep një panoramë zgjeruar (edhe me foto) të veshjeve popullore tradicionale të krahinave të veriu, duke u ndalur më shumë në zonën e Mirëditës, për qëndresën e të cilës kundra pushtimit otomna, shfaq simpati e respekt të madh. Po ashtu, shkrimi shoqërohet edhe me foto të Urës së Bunës dhe Urës së Mesit, bashkë me shpjegime për ndërtimin e tyre. Si përfundim lindin fare të natyrshëm disa pyetje për këto dy publikime. Si ka mundur një djale i ri shkodran të shkruaj artikuj me këto vlera për disa fusha të jetës shqiptare dhe t'i botojë ata jashtë vendit? Pse i ka bërë vend organi i shtypit, thuafe me autoritar italian, një publicisti (të themi publicist se atë natyrë kanë shkrimet) të huaj, kur atje shkollat e shumta nxirrnin çdo vit me dhjetra në mos me qindra gazetarë e historianë? A i ka shkruar drejtpërdrejtë në italisht shkrimet e tij Kol Maca, apo janë përkthyer nga shqipja? Mandej, a i janë kërkuar shkrimet nga redaksia e "Corriere della Sera" apo i ka nisur autori vet për botim?

Përgjigjet e sakta e shteruese të këtyre pyetjeve mund t'i japin kërkimet e mëtejshme (dhe të pritshme) për jetën dhe veprimtarinë e fotografit të dalluar Kolë Maca. Sidoqoftë, mungesa e deritanishme e përgjigjeve nuk e zbeh aspak vlerën e këtyre shkrimeve , përkundrazi e paraqet fotografinë shkodran, përveç mjeshtërit të aparatit edhe një publicist të aftë, me kulturë e mjaft kurajoz.



Luftëtarë mirditor

EKSPEDITA

NGA KURT GOSTENTSCHNIGG

Gëzimi paraparak për ekspeditën njëjavore të financuar privatisht nga një pjesë marrës shqiptar për në malësinë shqiptare u zbeh vetëm nga fakti se nuk mund të merrnin pjesë të gjithë kolegët dhe miqtë albanoologë të parashikuar. Më në fund morën pjesë shtatë veta: katër shqiptarë, dy nga Kosova dhe dy nga Maqedonia, një gjerman, një hungarez dhe një austriak. Unë e kuptova vetëm si një udhëtim pushimi, për të cilin kisha aq shumë nevojë, pasi kisha punuar pa ndërprerje në katër vitet e fundit. Gjatë ekspeditës vura re se kolegët e mi e kuptonin gjithnjë e më shumë si një udhëtim eksplorues dhe planifikonin një botim të përbashkët mbi të, për të cilin çdo pjesëmarrës do të kontribuonte me një lloj raporti personal. Shkencërisht i papërgatitur siç kisha hyrë në këtë ekspeditë, mund të mbështetesh lidhur me hartimin e këtij raporti vetëm në detyrën, të cilën ia kisha vënë vetes në fillim të udhëtimit: së pari dokumentimi i dinamikës së grupit tonë nëpërmjet fotografive dhe filmimeve të pjesëmarrësve dhe të gjithë grupit; më fund kisha arritur numrin inflator të 796 fotografive dhe 107 filmimeve, sepse kisha fiksuar edhe dashurinë time për natyrën, peizazhet, pyjet, malet, lumenjt, pemët etj.; së dyti dokumentimi i dinamikës sime të brendshme në formë refleksionesh të ndryshme.

Ekspedita filloi në Kosovën e Jugperëndimit me nisjen nga Prizreni dhe një shtegtim të parë të mrekullueshëm në Zaplluzh, Opoje, komunë të Dragashit. Në vazhdim nëpërmjet Junikut për në Gjakovë, Rrafsh të Dukagjinit, dhe nga atje për në Shqipëri të Veriut, ku do të vizitonim dhe shtegtonim Valbonën, Thethin dhe Kelmendin. Rugës morëm një banjë freskuese për këmbët – disa edhe për trupin – në një lumë mali. Ndërsa mua si shtajermarkas Valbona dhe Thethi më

Një artikull i shkruar mrekullisht qartë nga një albanolog i huaj për Shqipërinë, që përshkruan një ekspeditë në malësinë tonë. Një grup albanologësh, që janë endur në malësitë tona dhe kanë bashkëpunuar ngushtë me njëri-tjetrin. "Gjatë ekspeditës të gjithë kolegët e mi albanologë merreshin me aspekte dhe çështje historike, gjeografike, etnografike, ekonomike, politike, sociale, kulturore dhe kombëtare të zonës së vizituar, por edhe të gjitha vendbanimeve shqiptare në Ballkan", shprehet ai...



Shtegtime në malësinë shqiptare

Refleksione kontemplative të një albanologu

mua Thethi është mbreti i malësisë shqiptare. Vetëm për shtegun për tek ujëvara madhështore me kanalim e tij të ngushtë ujitës, uji i rrjedhshëm gurgullues i të cilin nuk është masazh vetëm për veshët, por edhe për zemrën dhe Shpirtin, ia vlenë udhëtimit. Kulmi i shtegimit tonë ishte shetgu i pjerrët nga lugina e Valbonës nëpërmjet qafës së Valbonës për tek lugina e Thethit, i cili na dhuronte pamje frymërrëmbëse dhe emocione të pagmueshme. Brenda vetes u ngritën kujtime për Nikaj-Mertur, ku kisha festuar në dhjetor 1992 në Mserr festën e Shën Nikollës me familjen e mësuesit të nderuar Dedë Sokoli dhe kisha pasur mundësinë të përjetoja në një fshat tjetër një gjëmë/gjämë burrash. E rikujtova eks-

Robert Elsie-t tonë të paharrueshëm, të mbretit të albanologjisë të ditëve tona, në Theth. Përballë bukurive të natyrës bisedat tona rrotulloheshin edhe rreth rrezikimit të tyre të mundshëm nga dyndja e pritshme e turistëve. Dhënia e licencave nga ana e një qeverie të mëparshme për ndërtimin e hidrocentraleve në malësi ka tashmë si pasojë një ndërhyrje masive në natyrën e paprekur. Rruga e planifikuar me asfalt për në Theth do të përmirësojë vlerat standardin e jetesës së vendësve në mënyrë të qartë nëpërmjet infrastrukturës pasuse, por do të shkaktojë edhe turizmin masiv të dëmshëm për natyrën dhe njeriun. Lëpusha e mrekullueshme në Kelmend të shndërrohet në një "peizazh fshatrash zviceran", me çka paraprogramohen kushte si në Tirol, në vend që të besohet më tej në turizëm individual dhe aventurë në një natyrë relativisht të paprekur. Pas një bisede impresionuese me një burrë të moshuar në Vermosh, të cilën e kisha filmuar pothuajse krejt, para se të darkonim peshk në Koplak tek liqeni i Shkodrës, bëme spontanisht një ekskursion të shkurtër për në Guçi dhe Plavë në Jugun e Malit të Zi, i cili ia vlejti vërtet.

Gjatë ekspeditës të gjithë kolegët e mi albanologë merreshin me aspekte dhe çështje historike, gjeografike, etnografike, ekonomike, politike, sociale, kulturore dhe kombëtare të zonës së vizituar, por edhe të gjitha vendbanimeve shqiptare në Ballkan. Përherë mahnetesha mbi dijen e tyre të përgjithshme dhe të hollësishe, por, meqë gjendesh në modusin e pushimeve, nuk kisha shumë qejf të merrja pjesë në këto diskutime historike dhe politike. Kolegu im gjerman dhe ai hungarez u hodhën në zjarr edhe për mua, duke iu përgjigjur pyetjeve historike dhe albanologjike të kolegëve tanë shqiptarë, të cilët natyrisht ishin kuresh-

Fjala e fundit për Shqipërinë nuk është thënë ende


Për sa i përket çështjes shqiptare, fjala e fundit nuk është thënë ende. Ne do të shohim, nëse pas dy ose tri gjeneratave do të gjendemi ende përballë një kombi të vetëm shqiptar apo – në qoftë se një Shpirt i ri kolektiv është tashmë duke u inkarnuar në një pjesë të shqiptarëve – një kombi shqiptar dhe një kombi kosovar, në analogji me manifestimin përfundimtar të një kombi austriak ndryshe nga ai gjerman jo më vonë se pas Luftës së Dytë Botërore.

dukeshin si alpet austriake në Tirol, Kelmendi ishte për mua si një kombinim nga Shtajermarku i Sipërm – maja të larta mali në sfond – dhe Shtajermarku i Jugperëndimit – peizazh kodrinor "Toskana" me përrën, livadhe të begata, pemë frutore dhe pyje të përzier. Dreka në Valbonë u shoqërua nga këndimi tradicional i burrave me lahutë dhe çifteli, ku nuk kuptoja gati asnjë fjalë nga përmbajtja heroike, por isha i prekur aq thellë nga efekti tepër i fuqishëm i zërave dhe instrumenteve, sa më mbusheshin sytë me lot. Në kullën e ngujimeve në Theth dëgjonim me nderim tregimet e pasardhës të rojave të kullës, saqë guxova të filloja vetëm në fund. Për

→ Vizion nga faqja 15

tarë për mendimet tona. Shqiptarët nuk e kanë zgjidhur ende çështjen e tyre kombëtare, prandaj, vetëkuptohet, kjo temë nuk i lë të qetë intelektualët e tyre. Ndërsa unë mbeta shpejt pa gojë nga madhështia e natyrës, shkova në përsiatje filozofike në brendësinë time dhe shijova të qenët bashkë me miq në mes të një flore dhe faune të papërshkrueshme. Kështu duhet të ketë qenë edhe për Edith Durham-in dhe Rose Wilder Lane-in. Unë doja ta përfetoja këtë ekspeditë nga një perspektivë e brendshme, kështu që ndodhën një shëndërrim i natyrshëm nga historiani dhe albanologu tek filozofi dhe poeti si dhe një zhvendosje e ndjimit nga koka tek zemra. shumë shpejt më rrëmbeu rrjedha e medimitit dhe u mbush dëlëngadalë me pyetje parimore dhe përgjigje të habitshme.

A nuk vihem shpesh në jetë para dilemës të shtetërisë për t'u përshtatur mainstreamit për shkak të interesit të lindur nga lufta për ekzistencë, apo të mbetem vetvetja për hir të detyrimit ndaj vërtetësisë së



ave. I Vetmi dhe Të Shumtët shpalojnë si Shpirti Kozmik si dhe Shpirtrat Individualë dhe Shpirtrat Kolektivë mundësitë e pafund të Të Qenit Suprakozmik-Transhendent në Të Bërit Kozmik-Immanent. Në nivelet e Të Qenit të pahapësirë dhe të pakohë jemi gjithmonë koshientë për unitetin. Në nivelet e Të Bërit hapësinor-kohor bëhemi hap pas hapi koshientë për unitetin tonë të humbur.

Vetëm pasi ne si individë dhe kolektiva ta kemi kuptuar dhe përvetësuar me kokë dhe zemër këtë fakt fundamental, do të jemi në gjendje që nëpërmjet një koshience dhe force të re të ndalojmë ende në kohën e duhur trenin, me të cilin po përshpejtojmë në mënyrë vetëvrases drejt murit të përplasjes të ndërtuar nga ne vetë, dhe t'i japim një drejtim tjetër, për të shpëtuar veten tonë si njerëzim nga shuarja e pashmangshme. Ne duhet të mendojmë vetëm për kërcënimin atomik, terrorizmin mbarëbotëror të të gjitha llojeve, mbipopullimin, ndryshimin e klimës të shkaktuar nga ngrohja globale e bërë nga njeriu, ndotjen dhe shkatërrimin e mjedisit si dhe harxhimin e papërgjegjshëm të burimeve natyrore. Nga skenari i pasojave të tmerrshme të rritjes së pakufizuar të

kohësh provueshmërinë shkencore të eksperiencave mistike/jogike ose shpirtëroro-spirituale në një mënyrë përgjithësisht intelektualisht të kuptueshme, duke parashtruar përbashkësitë ekzistuese në të gjitha kulturat dhe kohët të eksperiencave të tilla me të brendshme. Kjo – me shumë pak përjashtime – nuk ka depërtuar ende deri tek universitetet evropiane, të cilat i kushtohen si gjithmonë iluminizimit shumë të kufizuar. Arsyeya shkencore, e ndarë nga mistika dhe e ulur në fronin e ndërmjetësimit të së vërtetës, shpall Shpirtin dhe Perëndinë pjellë të fantazisë ose i kalon në heshtje dhe e quan materien shkakun e energjisë, megjithëse është e padukshme qe e lind të dukshmen dhe jo anasjelltas, duke i sjellë me këtë aq shumë fatkeqësi njerëzimit sa monoteizmi çifut, i krishterë dhe mysliman me pretendimin e tyre ekskluziv për të vërtetën hyjnore.

Nga këndvështrimi kontemplativ gjithçka duket e ndryshme. Ashtu siç katër albanologë shqiptarë, një albanolog gjerman, një albanolog hungarez dhe një albanolog austriak ishin simbolikisht në zemër të bashkuar për një javë në malësinë e "skipetarëve", ashtu jemi ne të gjithë – njerëz – të ngjryencë,

Shtegtime në malësinë shqiptare

brendshme? Vendimi për kërkimin e së vërtetës në kohën tonë do të thotë për individin dhe kolektivin dërrmimi midis mokrave neokapitaliste të lakmisë së pangopshme për fitim të të paktëve dhe të shfrytëzimit të pamëshirshëm të të shumtëve ose lufta donkishoteske me mullintë e erez të frymës së shpirtit të kohës, e cila po shtitet tek neokapitalizmi dhe popullizmi i djathtë. P. sh. historiani që jetojnë vetëm me kërkimin, detyrohen t'u ofrohen politikës, ekonomisë dhe kapitalit, për të marrë një të drejtë të ekzistencës dhe financimin e domosdoshëm për ushtrimin profesional. A nuk është edhe refuzimi për të mbajtur një "gojëz" të tillë, i cili ka përzënë nga atdheu i tyre mendimtarë të lirë intelektualë, siç kanë qenë Thomas Mann, Kurt Tucholsky dhe Stefan Zweig? Pyetja e përhershme e të qenit njeri i papërsosur është: a dua unë si krijesë e natyrshe dhe e vdekshme vetëm të mbijetoj sa më gjatë në ndarjen vdeqejprurëse në kurriz të gjallesave të tjera – njerëzve, kafshëve, bimëve –, apo dua unë si Shpirt i mishëruar të zbuloj veten time të pavdekshme dhe të jetoj në unitetin shpëtuës dhe vetërealizues?

Kjo nuk vlen vetëm për individin, personin, por edhe për kolektivin, popullin, etninë, kombin ose sido që ta emëtojmë dhe përcaktojmë, meqë të dy kanë një thell të brendshëm të qëndrueshëm, i cili shprehet nëpërmjet formave fenomenale kalimtare. Individit dhe kolektivit mund të zgjedhin: një jetë për formën e jashtme ose një jetë për qenien e brendshme. Ashtu siç Shpirti individual i mblehed të gjitha format e saja fenomenale – fizike, vitale, emocionale, mentale – rreth vetes, ashtu edhe të gjitha pjesët fenomenale, të cilat i përkasin të njëjtit Shpirt kolektiv, mbledhin në një bashkim të natyrshëm të vazhdueshëm, i cili në fund të fundit nuk është asgjë tjetër përveçse një çështje e vetme e kohës, ku forma e jashtme e vetërealizimit kolektiv – si shtet kombëtar me kufij territorialë "etnikisht" të përcaktuar, i cili është gjithmonë vetëm në kurriz të etnive dhe minoritetëve të tjera, ose si pjesë e një tërësie më të madhe si një shteti federal ose një federatë shtetesh – mund të variojë. Për ekzistencën e një koshience kolektive nuk duhen as preardhja e përbashkët, e cila çohet nga analiza e geneve ad absurdum, as shtetësisia e lidhur me një territor, por vetëm historia, kultura dhe gjuha e përbashkët dhe mbi të gjitha identifikimi personal. Kurdët p. sh. nuk kanë një shtet të përbashkët kombëtar, por e konsiderojnë veten pa dyshim si etni ose komb. Më shumë sesa njohuritë e tyre të gjithanshme mbi vendbanimet shqiptare dhe më gjerë më ka hyrë në zemër dashuria e kolegëve dhe miqve të mi albanologë sh-

qiptarë për kombin dhe popullin e tyre, sepse kjo tregon se miqtë e mi kanë arritur të bëhen koshientë për dimensionin shpirtëror të nocioneve mendore "komb" dhe "popull". Ky dimension nuk kapet me intelekt, por vetëm me zemrën e fshehur pas zemrës.

Për sa i përket çështjes shqiptare, fjala e fundit nuk është thënë ende. Ne do të shohim, nëse pas dy ose tri gjeneratave do të gjendemi ende përballë një kombi të vetëm shqiptar apo – në qoftë se një Shpirt i ri kolektiv është tashmë duke u inkarnuar në një pjesë të shqiptarëve – një kombi shqiptar dhe një kombi kosovar, në analogji me manifestimin përfundimtar të një kombi austriak ndryshe nga ai gjerman jo më vonë se pas Luftës së Dytë Botërore. Mirëpo ne nuk jemi vetëm austriakë, gjermanë, hungarezë, shqiptarë, serbë, grekë etj., por njëkohësisht evropianë, amerikanë, afrikanë, aziatikë etj., që të gjithë ne përsëri jemi një në të qenët njeri dhe akoma pafundësisht më thellë. Ashtu siç ndihem unë jo vetëm si austriak, por edhe si shtajermarkas perëndimor ndryshe nga shtajermarkasit lindor dhe të sipërm, si shtajermarkas ndryshe nga tirolezët, vjenëzët etj., si evropian të mesëm, evropian, qytetar të Tokës ose njeri dhe më në fund si Shpirt, i cili mishërohet suksesivisht në forma bimore, shtatore dhe njerëzore dhe, në transhendentën e tij mbikozmike, është një pjesë e përcjësme e Hyjnoret së papërkufizueshme, që i bashkon të gjitha kundërshtitë e mendueshme brenda vetes, ashtu një shqiptar mund të ndihet jo vetëm si shqiptar, por edhe si tiranas, shkoderan, prizrenas, tetovar etj. ndryshe nga durrësakët, vlonjatët, gjakovarët etj., si ballkanas ose evropian jug-perëndimor, evropian, qytetar të Tokës dhe më në fund si Shpirt i mishëruar në trup njeriu. Me një fjalë: një person mund të ndihet t'u përkasë disa kolektivave dhe prandaj të ketë disa identitete.

Gjatë shtegtimeve meditative në malësi shfaqeshin përherë imazhe simbolike në brendësinë time si ai i shumë diejeve brenda njërit diell. Pa ndërhyrjen e kokës zemra kapë e mënyrë spontane dhe intuitive të vërtetën e përmbajtur në të: misteri i përherëshëm më i lartë, më i thellë dhe më thellë shumë i thjeshtë është dashuria. Dashuria është Hyjnoria, Perëndia, njësisia ose uniteti. Njësisia përmban shumësinë. Prandaj ne mund të flasim për Hyjnoren si Njëri/I Vetmi dhe Të Shumtët. Njësisia përmban gjithashtu të qenët dhe të bërët. Shumësia përmban Individualen dhe Kolektiven. Pra, Njësisia në katër aspektet e saja themelore është Të Qenët, Të Bërët, Individit dhe Kolektivit. Njësisia është baza e shumësisë dhe me këtë më e larta dhe shkakut dhe qëllimi i të gjith-

ekonomisë, shkencërisht i vërtetuar në përgjithësi nga Dita e Shterimit të Tokës (Earth Overshoot Day) që çdo vit ndodh gjithnjë e më shpejt, na ka paralajmëruar me ngulm Klubi i Romës (Club of Rome) që në fillim të viteve shtatdhjetë. Kjo është sfida ultimative për ne të gjithë si individë dhe kolektiva. Shri Aurobindo, Meister Eckhart, Rumi dhe mistikë/jogistë/sufistë, profetë, filozofë dhe poetë të tjerë të të gjitha kohëve dhe kulturave na kanë thënë prej kohësh zgjidhjen në mënyrë të përsëritur. Princi i Vogël i bie pikës: "Njeriu vetëm me zemrën sheh mirë. Thelbësorja është e padukshme për sytë." Vetëm një ndryshim i koshiençës, i cili bazohet në unitetin e brendshëm, shkakton një ndryshim të të menduarit, të ndierit dhe të vepruarit dhe si pasojë e fundit një ndryshim të botës në kuptimin e një



Souvenir d'Albanie - A. J. burrë!

jetë në harmoni me natyrën dhe të një paqëje të qëndrueshme. Shumica e shkencëtarëve dhe intelektualëve nuk guxojnë ta shprehin ose madje ta shkruajnë këtë, disa ndoshta as të mendojnë një gjë të tillë, nga frika se do të përquhen për këtë nga kolegët, studentët dhe lexuesit e tyre dhe të dëmtojnë prestigjin dhe karrierën e tyre. Mirëpo Ken Wilber, i cili ka ndikuar ndër të tjerë Bill Clinton-in dhe Al Gore-in, dhe protagonistë të tjerë të menduarit integral kanë argumentuar prej

etnive, kombeve dhe feve të ndryshme – në të vërtetë një në thellësinë e Shpirtit. Ka ardhur koha të heqim dorë nga paragjykimet reciproke në kokë dhe zemër, të përfaqohemi dhe të pajtohemi si vëllezër dhe motra në Shpirt, në qoftë se dua t'u ofrojmë fëmijëve tanë një të ardhme më të mirë sesa e kemi pasur ne dhe paraardhësit tanë. Në qoftë se ndodh jo nga interesi, por nga një koshiençë e vërtetë uniteti, në qoftë se e do sinqerisht jo vetëm njëra palë, por edhe pala tjetër – pse Prishtina dhe Beogradi t'i mos japin shembull të mirë botës? Shumë lexuesve mund t'u duket si një utopi naive larg realitetit, por e parë afatgjatë evolucionin spiritual i njerëzimit, ky kërcim kuantik i dëshiruar i koshiençës së masës së madhe, i cili duhet aspiruar duke u larguar ndarjes fenomenale dhe duke u afruar unitetit esencial, meqë e lidhur me çlirimin e burimeve energjetike më të brendshme dhe më të larta sot ende të pamarrë mend, është shpëtimi ynë i vetëm nga fundi kolektiv, i cili po përgatitet dhe vetëpërshpejtohet gjithnjë e më shumë, dhe nga i cili nuk do të na ruajë përparimi sipërfaqësor teknik dhe digital, derisa nga ana e koshiençës ne mbetemi të lidhur ngushtë me dualitetin dhe natyra jonë njerëzore nuk ndryshon parimisht. Ka ardhur koha kur byku të ndahet përfundimisht nga gurri. Sado të zgjasë ky proces – me hapa të vegjël të ngadalë apo me një kërcim të vetëm të gjatë: manifestimi hapësinor-kohor i Hyjnoret në Tokë në kuptimin e shfaqjes së gjendjes supreme Të Qenë-Koshiençë-Forcë-Lumturë është i pandalshëm. Mirëpo kundërshtimi brenda dhe rreth nesh mund të rritet pothuajse deri në të padurueshme dhe të marrë përmasa apokaliptike përtej forcës sonë të imagjinatës. Prandaj pyetja vërtet e madhe për çdo individ dhe kolektiv është: a do të qëndrojmë në anën e së vjetrës apo të së resës? A do t'i mbyllem apo t'i hapemi shëndërrimit radikal të mendjes, jetës, trupit dhe materies? A do të ndodhë transformimi sufragant, i cili e tejkalon pafundësisht sferën mendore, me një njerëzim të bashkuar dhe të vetëkapërcyer duke u shfaqur një lloj i ri spiritualisht mbijnjëzëzëz, apo pa njerëzimin e pabashkuar duke u manifestuar një qenie suprakulturale? Dhe çfarë do të bëhet me Evropën, Austrinë, Shqipërinë dhe Kosovën? Lajmëtarë ose Avatarë i këtij krijimi të ri ka thënë një herë: "Evropa kronohet me organizimin dhe efikasitetin e saj praktik dhe shkencor. Unë pres që organizimi i saj të jetë i përkryer. Pastaj një fëmijë do ta shkatërojë."

Këto të gjitha mund t'u pëshpërisë njeriut uju gurgullues në Theth, në qoftë se i vihet në qetësi veshi i zemrës...

F
ESSE

Nga inati më vjen të them: Liria qenka nëna e të gjitha luftërave. Kështu shprehet akademiku i njohur Rexhep Ferri në një nga esetë që e ka përcjellë enkas për "Milosaon". Mundimi më i madh i tij është për të treguar përmes fjalës kaosin që e ka ngërthyer qenien shqiptare dhe që e mban fort shtrënguar. Ai nuk tutet të tregojë mërzinë, frikën dhe konfuzionin e tij të madh...për këtë mjedis që kanë krijuar shqiptarët dhe që po kthehet në armikun më të madh të vetë shqiptarëve...

ORA
ME
QYQE

NGA REXHEP FERRI

1. Kujt t'i themi se ku ishim?!
Pse ishim?
Gjatë çdo lufte e pas çdo lufte kemi shkuar nga e kaluara në të kaluarën dhe kemi pritur me vite e vite për ta zbuluar vetveten në afërsi të një rruge të vogël qorre, që mban emrin "Albania Turka", "Albania Veneta".
Kësaj pranie historike të dhimbshme e me burime të ligjshme e të paligjshme nuk e di pse i kemi besuar aq shumë.
Edhe pse koha gjithmonë ishte që të mos besojmë në diçka që nuk e njohim dhe në diçka që nuk e dijme se nga na vjen:
-Pse na vjen!
-Kujt ia lëmë fajin?
Lart zotat.
Poshtë kafshët, për të mos thënë bishat.
E njerëzit?!
Eh, njerëzit ende kanë frikë nga frika e akuzave të heshtura...

2. Pastërtia e luftës moderne pa dyshim është diçka e rrallë.
Nga iluzionet mashtrimet, ka shpëtuar kush ka shpëtuar.
Me ndikime bizantine vlerat njerëzore ende i shohim vetëm si ëndërr.
Pa kuptim të drejtpërdrejtë e as të figurshëm me vite kemi jetuar të kompleksuar pa e kuptuar e pa e ditur çka është kompleksi.
Tani na vjen të flasim: Po kujt t'i flasim!
Kurrë nuk e kemi kuptuar pse jemi kaq të pafinuar.
Gjeografikisht botë e njohur.
Botë e panjohur.
Për të qenë të qartë shpejt na iku koha e patriotizmit.
Loja me fjalë mbeti si mundësi e kapur e korrigjimit të kufirit mes shqiptarëve.
A kemi ndonjë shpresë, po ashtu nuk e di?!
Si nuk po e kuptoni se ende jemi larg?!
Marrëdhëniet mes njerëzve ndoshta janë edhe më keq se ato të gjatë historisë së pashkruar.
Për një mundësi tjetër të dytë ende seriozisht nuk është biseduar.
Nga retorika mashtruese niveli i shërbimit intelektual ka rënë në fund të pusit.
Fundi i marrëzisë thjesht qenka diçka e pabesueshme.
Provojeni kujtesën.
Pas luftë nuk mund të themi asgjë për luftën.
Kush e bëri?
Pse e bëri?

3. Kjo e ajo qeveri, me nipër e kushërinj, me dajë e dajallare dhe me miq që krijojnë mjegull, publikisht flet se e drejta e njeriut është e garantuar me ligj.
Por nga ligjet e pashkruara edhe peizazhi ka ndryshuar.
Për njeriun ndryshimi nuk qenka problem.
Çka është jeta përballë përjetësisë?
Me një kuptim të ri?
Me një kuptim të harruar?
Për ju që jeni atje:
Për ne që jemi këtu as rregullat e lojës nuk kanë më vlerë.
Nga na erdhi kjo famë?
A ka fajtor?
Shkoi fytyra!
Njerëzit janë bërë numër kritikë.
Është bërë e pamundur ta ruajmë qetësinë shpirtërore.
Jeta paska shumë mashtrues.
Natyrisht, me pasoja të rënda.
Nga pamja e njohur nuk mund ta lë pa e thënë, por edhe nuk po di si ta them e kujt t'ia them.

Nga inati më vjen të them: Liria qenka nëna e të gjitha luftërave.
Për ne që i kemi humber shpresat, që ende kemi frikë të dalim pa frikë nuk do të ketë herë të tretë.

4. Dragoi i imagjinatës kineze me premtime universale për "Albania Turka", "Albania Veneta" nuk kishte ditur asgjë.
Ky tregim është një përpjekje dëshpëruese për të shpëtuar nga dëshpërimi.
Por kujt po ia ndien për njerëzimin?!
Fundit i ka ardhur fillimi.
Ka rreziqe të panjohura që mund të shpërthenin?
Nuk e di.
Kurrë nuk kemi qenë më afër e më larg se sot të bëjmë vetëvrasje.
Njeriu edhe sot ka dilema.
Edhe pse frika është tejkaluar, njeriu edhe në gjumë, edhe në ëndërr ka frikë nga frika.
Ende nuk i ka ligjet e shkruara për t'u mbrojtur.
Çdo gjë e ka qëllimin e vet.
Njeriu me famën e pushtetit të vet e ka edhe çmendurinë e vet.
Në fushën e mejdanit, gjithmonë me dy largësi.
Me frikë nga njeriu dhe frikë nga arti i vetmisë.
Sipas viteve e sipas shekujve është mësuar për t'i llogaritur krizat.
Të kërkon farë ustahu për ta kurdisur.
Ora me Qyqe, është Ora e Lutjeve:
Qyqe, Qyqe, kryekuqe, pash mu, pash syret Ali-un sa vjet m'i jep me r'ruue.



Por, Qyqja si Qyqe: Ku – ku, ku – ku, ku – ku...
Për ta ruajtur ose për ta gjuajtur si hekurishte e vjetruar e të ndryshkur.

5. Tani ëndrrat nuk janë sa për ta lidhur e zgjidhur ushkurin.
Përtej vijës së kuqe s'ka ligje të shkruara e as lehtësi ligjore.
E bardha në letër.
E zeza në letër.
Dhe asgjë më afër se sytë e fshehur prapa perdes.
Pa të drejtë, hap pas hapi në pikëpamje kohore ende nuk jemi duke e ditur se në ç'kohë po jetojmë.
Lidh e zgjidh ushkurët nuk pyet njeri.
Rrëfimi i madh s'het armë për ta shkatërruar botën pa pyetur sa kushton çmimi i jetës.
Nënati e fëmijëve ende të palindur mundohen të kuptojnë se kush është fajtor.
Për t'i fshehur gjurmët, kësaj krize po i shihet vetëm fillimi.
Ushtarët e plagosur, që kthehen nga lufta, të parët e kuptojnë dhe të parët e pëshurrin patriotizmin e sojlinjve tanë të rrejshëm.

6. Tre.
Pesë.
Dy.
Ku je ti?
Ku jam unë?
Për ta ngacmuar pikën në gjumë, ku është fjalja?
Vija e kuqe?
Duke shkëlur përtej artit as Zoti nuk është më Zot.
As Olimpi me qetësinë olimpike.
Edhe kur dikush më flet mirë, nuk jam i sigurt se nuk ka diçka nën plaft.
Sa larg jemi, është vetëm pyetje.
Nga liderët tanë kemi urdhër ta djegim shkollën.
Kujt po i duhet më shkolla!
Kositni livadhet.
Mbledhni të korrat.
Ka të ngjarë se do të hamë barë...
Bordet e privatizimit dhe kuratorët e arteve kanë parë një ëndërr: Ruajna zot mendjen!...
Për inat të armikut, fjalës ia kemi prerë gjuhën.
Sa më pak që e kuptojmë, aq më pak probleme.
Nga pika afër polit të veriut kemi përjetuar shumë humbje.
Tani s'kemi as çka të fshehim, as çka të ruajmë e as çka të humbim.
Nga iluzioni edhe unë u plagosa.
Nga helmi u shërova.
As të varri i gjyshit nuk ka mbetur gur mbi gurë...

7. Çmenduria sot është avanturë e re.

Me artin e vetmisë mos mendoni se teknologjia është shpëtim.
Pas luftës kam punuar si kamerier.
Një ditë, një sojlinj, pasi ngrëni drekë nuk deshti të paguajë.
E pyeta: Pse?
- Unë nuk paguaj, më tha! - Jam zëvendëskomandant dhe nuk paguaj.
Pronarit i tregova se si një zëvendëskomandant nuk don ta paguajë drekën.
Për befasinë time, pronari qeshi dhe më tha:
-Unë po them qitja edhe një drekë. Ai fare sojliu qenka vetëm zëvendëskomandant. Të gjithë të tjerët janë vetëm komandantë.
As bota nuk e ka imazhin e dikurshëm.
Për fillimin e ri ia kemi trusë sipas çmendurisë së fundit.
Me kthesa e pa kthesa, pak a shumë si në Parajsën e Humber.
Kështu e kemi jetën.
Fundin e meselesë.
Bindjen e fortë.
Si në det të hapur.
Si në shpellë të ujkut.
Mend për tjetër herë.
Fitorja e madhe i ka edhe shtatë ditë.

8. Janë ca gjëra që nuk na lënë ta kuptojmë botën.
Kemi harruar të mendojmë se nuk ka gjë më të rëndë se kur nuk e dime se ku e kemi të ardhmen.
Jemi bërë të huaj edhe për vetveten.
Sot askush nuk jeton pa frikë.
Frikën tani e kemi stil jete.
A kemi bërë diçka që do të mbetet?
A kemi vjedhur e shitur diçka me shpatë, me thikë, me të keq, me të egër -pyeta pasqyrën dhe u ndala.
Kokën e ktheva prapa.
Nga trëmuja e viteve vetëm të çmendurit mendojnë se kanë të drejtë...

9. Jemi duke folur për një luftë menjëherë pas lufte.
Për një liri që ka frikë të dalë nga ku ka qenë e fshehur.
Ajo mendon se ende jemi në kohë lufte.
S'ka dëshirë të flasë as për luftën e as pse bëhet lufta.
Për një njohje njerëzore pse nuk po kuptoni se çka është duke ndodhur, edhe pse pak a shumë jemi të gjithë të krisur nga mendja.
Pasojat ndoshta nuk janë të ditura.
Thashethënat janë të shumta.
Nuk dihet se deri ku mund të shkohet.
Në qendër të vëmendjes nuk kemi asgjë të kuptueshme.
Çka do të na sjellë fati nuk e di.
Nga ky lloj pazari politik nuk po e njoh as vetveten.
Njeriu e ka humber besimin.
Ku do të ndalet nuk e di.
Me heshtje po e shpreh ngushëllimin.
Ky tregim është një pasqyrë dëshpëruese.
Po kujt po ia ndien për njeriun.
Në faqen e parë të një gazete ditore pashë karikaturën e Skënderbeut të ulur në një karrigë duke nënshkruar një dekret.
Lart në mur, mbi kokën e Skënderbeut, ishte i vendosur portreti i Enver Hoxhës.
Sikur historia të ishte pak më ndryshe Pikaso nuk do të ishte tallur edhe me vetveten.
Nga fama, përtej famës, Pikaso duke parë se si po e kopjon vetveten, i zbrazur dhe i mërzitur nga të gjitha shpesh i vinte për të vjellur.
Nga kjo pikë edhe piktori italian Piero Manzoni, mutin e vet e ka konservuar dhe e ka shitur me etiketën: "Mut, qind për qind i pastërt artistik!"
Për dikë provokim. Për dikë tjetër çmenduri.
Kjo çudi për t'u çuditur flet se kush jemi e ku po shkojmë e çka po kërkojmë.
Zoti siç e kërkojmë ne për ta parë nuk ekziston.

Gusht, 2018

P

POEZIA

Këto poezi janë propozuar nga shkrimtari dhe studiuesi Agim Vinca. Ai flet me nderim për poetin, por ndërkohë na ka sjellë të shqipëruar mrekullisht një pjesë të tyre.

Cili është Raiçkoviq

Stevan Raiçkoviq (1928-2007) është një nga poetët më të njohur bashkëkohorë serbë. Kultivon kryesisht trajtat e lidhura të vargut: distikun, katrenën dhe sonetin, por me një lirizëm të theksuar dhe sensibilitet modern. Libri i tij "Ninulla e gurit" (1963) është përkthyer në shqip nga poeti Enver Gjerçeku (botuar te "Rilindja" e Prishtinës në vitin 1966). Poezitë e mësipërme janë marrë nga krijimtaria e tij e mëvonshme, ku hyn edhe libri që i kushtohet një kositi cigan të shtrirë në spital, "Këngë për Vladimirin e zi" (1971).



NGA STEVAN RAIÇKOVIQ

SHTATORI

Ndalu pakëz, këngë, ndalo!
A jetuam, apo jo?

Ti çastet më të bukura moj
- Kur plepat shtatgjatë si hej

Marrin ngjyrën e arit -
M'i fale mua të gjorit.

SHTATORI

(Variant)

Ndalu pakëz, këngë, ndalo!
Jetuam, vallë, apo jo?

Ti çastet e mia më të mira
- Në shtator kur plepat prarohen

M'i shpurre larg në mjegullira -
Çastet që nuk harrohen.

UNË S'E SHKRUAJ KËTË PËR VETE E PËR TY

Unë s'e shkruaj k'të për vete a për ty
Po për atë që një ditë do të vijë.

Dhe një natë diku (në një dhomë të ftohtë)
Ç'do të thotë, vallë, ai, ç'do të thotë?

Ai që ndoshta veç një mendim ka në mend
Se është i vetëm në k'të botë dhe pa askend.

Për një çast të tillë, o i panjohuri njeri
Unë një natë të tërë nuk kam mbyllur sy.

Dhe nëse ti i mrrorol tund kokën e thinjme
Paskësh vajtur kot gjysm' e jetës sime!

MË THUAJ, KËNGA IME, Ç'ËSHTË KY DRU KËSHTU

Më thuaj, kënga ime, ç'është ky dru kështu
Në shesh, mes asfaltit, hu i vetëm, hu!

Mos është farë hyjnie i botës pyjore
Kapur në veriga nga një dorë mizore?

(Ndoshta dhe ne tok shëmb'ilejmë në një shajni
Tek vigjëltojmë natën buzë lumit në vetmi)

Dhe mu në këtë çast, shih, druri degëgjerrë
Në vështron në sy, mua është ty, për nder.

I heshtur, pa fjalë, në natën pa cak
Kokën time mbështes te sup i tij i vrazhdë.

Dhe ngajmë si dy miq në cikmë e në llohtë
Që ia behën këtu kushedi nga ç'kohë.

KËNGË PËR SËMUNDJEN E VLADIMIR PURIQIT

Vladimir Puriqi nga fshati Sopot
Dergjet në shtrat një dimër të plotë.

Në dhomën e bardhë Vladimiri i zi
Sodit nga dritarja të mbramen borë të tij.

Gjithçka rreth tij zhytet në bardhësi të butë
Veç zi mendon Vladimiri i smutë.
Tevona u kujtua hëna në arë
Dhe vetja fillikat duke kostitur bar.

Më pyet me sy i miri Vladimiri:
"Do të vdes vallë a do të kosis sërisht?"

Do të dalësh prapë në livadh, or kosaç,
Nuk ta shkrova kot këtë vjershë si ilaç.

PËRMENDORE NË PËRKOS

Nuk ngritëm as dhe një gur ne të ngratit
E të gjithë ramë nga dorë e xhelatit.

Dikur ishim burra, gra e fëmijë
Tani s'jemi më as pluhur as hije.

Dhe askush nga ne këtu nuk kthen dot
Nga natë e zezë pis që na hëngri atëbotë.

Por do të vijmë herë-herë mbase një mëngjes
Të shndërruar në bar, në borë a në vesë.

Shënim: Kjo poezi u kushtohet serbëve të vrarë nga ustashët në fshatin Përkos afër Karilovcit më 12 dhjetor 1941, por tingëlton si t'u ishte kushtuar shqiptarëve të ekzekutuar nga forcat serbe në fshatin Reçak të Shtimes (Kosovë), më 15 janar 1998. Provon'i t'i vini kësaj poezie titullin: "Për të rënë në Reçak" dhe do të shihni se funksionon plotësisht. Kjo tregon forcën përgjithëse të artit dhe konfirmon faktin se krijimtaria i superon pikëpamjet politike të autorit.

EPILOG

Mbështjellë me t'rëndën pelerinë
Dhe kosën përmbi krahe
Përvidhet kostari mbi kodrinë
Sikur nga guri ka dalë.

Vjell tym oxhaku i mjerë
Përmbi fshat e lëndinë.
Nata është e zezë sterrë
Me një pikë të bardhë shqipim.

Shqipëroi: Agim Vinca

O

OPERA

NGA SUL GRAGJEVI, KRITIK MUZIKE

Aida është opera më e suksesshme e repertorit të grand operas së shekullit të 19. Ismail Pasha, kedivi i Egjiptit, i propozoi Verdit që të shkruante një opera me përmbajtje nga historia e vjetër e vendit të tij. Vepra u komisionua nga Khedival 'opera house' e Kairo. Premiera do të shfaqej në vitin 1871, por u vonua dhe nuk u dha në datën e caktuar, sepse kostumet dhe pjesët e dekorit që do të vinin nga Parisi u vonuan për arsye të luftës Franco-Prusiane. Përfundimisht, opera u shfaq në Kairo, më 24 Dhjetor 1871.

Eshtë folur shumë sikur opera është shkruar posaçërisht për t'u shfaqur në ditën e përirimit të Kanalit të Suezit, po kjo s'është e vërtetë. Në atë ditë u shfaq opera tjetër e Verdit, "Rigoletto". Verdi ishte vërtet i lumtur që po e shkruante Aidën në prag të hapjes së Kanalit të Suezit, por refuzoi ta kompononte sipas urdhërave diktuar nga të tjerët. Madje, ai nuk pranoi të shkruante as Himnin e Përirimit të Kanalit, për të njëjtën arsye. Verdi nuk i pati duart e lira në subjektin e libretos, por Ghislanzoni i dha atij një libër të mrekullueshëm.

Kompozitori i madh e shkroi operën në bashkëpunim me libretistin italian Antonio Ghislanzoni, duke u konsultuar edhe me egjiptologun frëng Auguste Mariette. Është bërë e njohur që, prej vitit 1886, Aida është shfaqur mbi 1100 herë dhe degjohet gjithmonë me admirim si nga muzikantët, ashtu dhe nga publiku i gjërë. Ajo konsiderohet "opera e këngëtarëve" dhe këta këngëtarë duhet të kenë zë madhështor, ashtu si arkitektura kolosale egjiptiane. Vepra është kombinim i shkëlqyer i "grand operas" më të përpunuar me bel canto dhe me teknikë orkestrale moderne. Ajo përbën një fazë të re në zhvillimin e krijimtarisë së kompozitorit si dhe të stilit të ri. Megjithatë u shfaq në vitin 1871, opera ka ende freskinë artistike, nuk ka humbur asgjë, admirohet universalisht dhe është shumë popullore. Ajo është, gjithashtu, e para midis shumë veprave të tjera të Verdit, që braktisi "momentet e mëdha" në favor të një punimi integral të kompozitorit. Dramaciteti i operës rritet dhe rrjedh në mënyrë llogjike; skenat spektakulare janë pjesë e kësaj llogjike. Giuseppe Verdi ishte i dëshpëruar me traditat e "scrittura pratica"-s, të cilat kërkonin subjekte mesjetare, me pasion pa kufi. Me Verdin, opera tregoi një zhvillim të madh në çdo aspekt, në melodi, në harmoni e orkestracion gjithashtu dhe në formën e organizimit. Skenat madhore janë të mprehta, veçanërisht kur Verdi përdor një deklamim të thjeshtë. Gjithsesi në vepër nuk ka asgjë të zakonshme; dëgjuesi është tërësisht i zënë sapo fillon opera me preludin fin, e pas tij me duetin, që lartësohet mrekullisht.


Veçori veçanërisht e lavdërueshme e operas Aida është mënyra me të cilën Verdi përdori me mjeshtëri kolorin lokal. Në vend të ekzotizmit dhe të ori-

Më 26 shtator - 6 tetor të pasionuarit e muzikës lirike do të shohin në skenën e tempullit operistik të Nju Jorkut operën 'Aida' të Verdrit. Krahas sopranos superstar Anna Netrebko, në rolin e Aidës, në skenë do të jetë Anita Rachvelishvili, për Amneris-in, ndërsa Aleksander Antonenko do të interpretojë rolin e Radames-it. Në podin e dirigjimit, Nicola Luisotti.

entalizmit, ai përdori tërësisht koncepte harmonike, melodike dhe orkestrale perëndimore për të ngjallur një atmosferë tërheqëse, ndërsa në skenën e Nilit, avancoi në fushën kompozicionale sipas Claude Debussy-së.

Opera përbëhet nga katër akte: Akti i parë zhvillohet në dy skena, në pallatin mbretëror, në Memfis. Gjenerali i ri egjiptian, Radamesi, mëson nga Ramfisi, kryeprieti i Egjiptit, që etiopasit i kanë shpallur luftë përsëri egjiptianëve. Ramfis shkon për të njoftuar Faraonin. Radames shpreson se do ta zgjedhin komandant dhe dëshiron që të fitojë në fushën e betejës, mënyrë që të ndihmojë Aidën, bijën e mbretit të Etiopisë me identitet të fshehur, të cilën egjiptianët e kanë kapur dhe e mbajnë të robëruar. Ai e dashuron atë në fshehtësi. Aida gjithashtu e dashuron Radames-in. Në skenë shihet të hyjë Amneris, princesha egjiptiane, që shpreson të fitojë dashurinë e Radames-it, ndonëse ka një parandjenjë që zemra e tij i takon dikujt tjetër. Kur vjen Aida, Amnerisi vë re një ndryshim në sjelljen e Radames-it dhe e kupton që Aida është rivalja e saj, por mundohet ta fshehtë xhelozinë që ka dhe i afrohet Aidës, duke u shtrirë si mikeshë. Vjen lajmi se etiopianët, të udhëhequr nga mbreti i tyre Amonaso, i janë drejtuar qytetit të shenjtë Teba. Faraoni shpall gjendjen e luftës dhe e emëron Radames-in komandant të ushtrisë. Të gjithë duan që ai të kthehet fitimtar, ndërsa Aida fajson veten e saj që dashuron njeriun, i cili drejton ushtrinë e tij në luftë kundër babait të saj, i nisur në luftë për të shpëtuar të bijën. Pritërinj e pritëresha si dhe gjithë të tjerët, me këngë e valle luten për për fitoren e ushtrisë egjiptiane.

Akti i dytë zhvillohet gjithashtu në dy skena. Egjiptianët festojnë fitoren e Radames-it dhe të ushtrisë egjiptiane, duke



kënduar, ndërsa Amneris përgatitet të presë në dhomat e saj fituesit. Ajo ende nuk është e sigurt në dashurinë e Radames-it dhe pyet veten e saj, "A thua Aida është vërtet e dashuruar pas gjenralit të ri?" Aida hyn brenda duke mbajtur kurorën, të cilën Amneris duhet t'ia dorëzojë Radames-it. Që të kuptojë ndjenjat e Aidës, Amneris i thotë asaj se Radames është vrarë në luftë. E shokuar, Aida pranon që zemra i rreh për Radames-in, ndërsa Amneris tërbohohet dhe, në mllaf e sipër, i tregon Aidës të vërtetën: "Radames është gjallë!" Para se të ndahet, ajo i thotë Aidës që do të hakmerret ndaj saj.

Në skenën e dytë, Radames hyn triumfalisht me trupat në qytetin e shenjtë Tebë, bashkë me ushtarët etiopianë të zënë robër; midis të cilëve është edhe mbreti Amonasro. Amonasro, i maskuar, u thotë të gjithëve, se mbreti i Etiopisë është vrarë në luftë. Faraoni e shpall Radames-in fit-




në fraza të veçanta me një zë "ton-color", duke kërkuar thellësi të re të imagjinatës, ndërsa Simonato, në rolin e Amneris-it, ishte një mezzosoprano e përsosur; ajo siguroi portretin brilant të një karakteri të rëndësishëm.

Një tjetër nga performancat e regjistruara me cilësi të lartë ishte ajo e vitit 1955, e dirigjuar nga legjendari Tullio Serafin. Në këtë performancë të La Scala-s, kënduan Maria Callas (Aida), Fedora Barbieri (Amneris), Richard Tucker (Radames) dhe Tito Gobbi (Amonasro). Callas-i portretizoi princshën Etiopiane në mënyrë mahnitëse kundrejt mjeshtrisë dramatike të Tito Gobbit, në një partneritet të suksesshëm ashtu si te Tosca e Puccini. Dueti i tyre në klimën e skenës së Nilit ndiqet nga aria madhështore e Aidës, "O patria mia", që qe e pakrahasueshme. Notat e larta të saj ishin edhe këtu si dy vjet më parë në Covent Garden, kur performancën e dirigjoi John Bar-

"Aida" në "Metropolitan Opera"

imtar dhe deklaroi se i jep të bijën Amneris për grua si dhe çdo gjë tjetër që ai dëshiron. Radames i lutet Faraonit që të lirojë robërit e luftës dhe Faraoni e pranon këtë kërkesë. Ai i liron të gjithë përveç Aidës dhe babait të saj, të cilët i mban, sipas këshillave të Ramfisit, si kushit që etiopianët të mos sulmojnë më Egjiptin.

Akti i tretë zhvillohet te bregu i Nilit afër faltores, ku Amneris, e shoqëruar nga Ramfis, vjen që t'i lutet perëndeshës Izida për martesën e lumtur me Radames-in, duke mos e ditur që Aida do të takohet aty me Radames-in. Vjen fshehurazi dhe Amonasro, i cili kërkoi nga e bija të mësojë nga Radames rrugëkalimet e ushtarëve etiopianë, me qëllim që etiopianët të sulmonin befasisht përsëri Egjiptin. Por Aida refuzoi, ndërsa i ati e mallkon: "Ti s'je më vajza ime, por një skllave e Faraonit". Duke parë që po vjen Radamesi i cili kërkoi për të dhënë gjë tjetër, Radames i shpreh me zjarr Aidës dashurinë, duke i premtuar edhe martesën. Ajo mundohet ta bindë të dashurin që të ikën së bashku në shkretëtirë, kurse Radames i propozon të largohen në rrugën nga ku nuk kalojnë ushtarët etiopianë. Nga faltarja del Amneris e cila rastësisht bashkë me kryepriestin Ramfis ka dëgjuar bisedën e tyre. Radames, pëlqohet dhe akuzohet si tradhtar, por e mbron Aidën dhe të atin e saj, ndërsa ai vetë dorëzohet të garda. Aida dhe Amonasro ndërkaq largohen. Amneris i premtim Radames-it se do ta shpëtojë, nëse ky do ta har-



rojë Aidën. Por ai është i palëkundshëm ndaj lutjeve të saj. Atëherë fillon gjykimi për tradhëtinë e tij ndaj atdheut. Radames hesht gjithë kohën, duke mos iu përgjigjur tri akuzave të paraqitura nga Ramfis. Amneris i bën të ditur Radames-it që Aida nuk është ekzekutuar ende, ndonëse priftërinjtë e kanë dënuar me vdekje dhe do ta vendosin të gjallë nën themelin e faltores. Amneris u lutet priftërinjve për mirësi, por ata nuk bëjnë asnjë lëshim.

Skena, ndërkaq, ndahet në dy pjesë. Njëra tregon një tempull dhe Radames-in e mbyllur brenda varrit, ndërsa pjesa tjetër tregon Amneris-in mbi varr. Duke menduar se është vetëm, Radames i lutet asaj që Aidën ta shpjerë në një vend të sigurt. Ndërkaq, ai dëgjon diçka dhe, para syve të tij, shfaqet Aida e fshehur, që dëshiron të vdesë bashkë me të dashurin e saj. Pas kësaj dëgohet recitativi - pasazh i tretë i skenës së varrit - me shoqërim orkestral, si një këmbanë vdekjeje, që shkrihet në një frazë melodioze të bukur dhe të harmonizuar, ku Aida i thotë Radames-it që do të vdesë aty, në krahët e tij. Radames mundohet të ngrejë pllakën e varrit, po e sheh se s'ka shpëtim për ta. Të dy të dashruarit e pranojnë fatin e keq të tyre dhe vdesin të përfuqur, ndërsa mbi faltore, Amneris i lutet perëndive që t'i dhurojnë Radames-it paqë të përjetshme.

Në një letër dërguar libretistit të tij gjatë krijimit të skenës së fundit, Verdi shkruan: "Do të preferoja diçka të ëmbël, qiellore, një duet shumë të shkurtër, si një lamtumirë ndaj jetës. Aida duhet të perëndojë në krahët e Radames-it. Ndërkohë, Amneris, e gjuhëzuar në pllakën e gurtë duhet të këndojë "Requiescant in pace" ("Të pushojnë në paqë"). Pas kësaj Aida dhe Radames fillojnë duetin e tyre final të ndarjes me jetën e trishtuar dhe të kalimit në përjetësi".

Në aktin e katërt, skena e varrit është tepër e veçantë. Pas recitativit, Radames/Aida, introduksioni orkestral i harqeve është i qetë dhe sjell një gjendje të trishtuar. Radames këndon ngadalë, i shoqëruar nga muzika:


"La fatal pietra sopra me si chiuse;

Ecco la tomba mia.

Del di la luce più " non vedro ...

non rivedrò più Aida".

("Guri fatal mbi mua po mbyllet. Ja varrim. Nuk do të shoh më dritë nga lart... Nuk do ta shoh më Aidën"); ndërsa Aida, e shoqëruar nga orkestra, me nota të regjistrit të poshtëm shpreh gjendjen e saj të rëndë dhe vendosmërinë për të vdekur në krahët



e Radames-it:

"In questa tomba che per te s'appriva

Io penetrai furtiva,

"E qui lontana da ogni umano sguardo

Nelle tue braccia desiai morire".

Pas kësaj, vijnë dy ariozos, që Verdi i ka shkruar, njërin për Radames-in dhe tjetër

për Aidën.

Radames reagon "Con passione"

"Morir! si pura e bella!

Morir per me d'amore!"

Degli anni tuoi nel fiore.....

Aida është e eksituar. (harqet e lartë)

"Vedi? di morte l'angelo

Gia' veggio il ciel disciudersi;

Ivi comincia l'estasi

D'un immortal amor.

Ndërsa në duetin që vijon mes Aidës dhe Radames-it, Verdi përsërit dy herë lamtumirën e tyre për jetën dhe tokën.

"O terra, addio, addio, valle di pianti,

Sogno di gaudio che in dolor

svani,

A noi si chiude il ciel....

Amneris dëgohet të kërkojë paqë, "Pace t'imploro, salma adorata", ndërsa kori i këndon pafundësisë së përjetshme.

Performancat e operës "AIDA", janë kthyer shumë herë në ngjarje të mëdha muzikore. Në vitin 1959, Herbert von Karajan dirigjoi performancën e Vienës, ku kënduan Renata Tebaldi (Aida), Giulietta Simonato (Amneris), Carlo Bergonzi (Radames), Cornell MacNeill (Amonasro), të shoqëruar nga Kori dhe Orkestra e Operas së Vienës. Carlo Bergonzi në pjesë të veçanta ishte një tenor model, me pasion të madh dhe në partneritet me Tebaldin, ai ishte një Radames heroik, plot shkëlqim. Renata Tebaldi paraqiti një portret verdian të Aidës, ajo këndoi

birolli. Tenori Tucker në rolin e Radames-it realizoi një figurë të bukur, fine dhe heroike, ndërsa Fedora ishte një Amneris mbresëlënëse gjithë kohën. Përpara siparit final, një figurë e trishtuar futet në tempull mbi varr për tu lutur. E tharë nga i gjithë ai emocion, që u derdh në skenat e mëparshme, Amneris-i mundi vetëm të pëshpërishte në monotoni: "Paqë, pusho në paqë, unë lutem" ("Pace t'imploro"), në kontrast të fortë me violinat e "larta", që marrin përsipër melodinë e duetit Radames-Aida të ngjites drejt "dritës së përjetshme".

"Arena" e Veronës është kthyer tashmë në një emblemë, teksa në parafytyrimin tonë vjen përherë me trombat e drejtuar nga qielli, gjatë "Marshit triumfal" të "Aida"-s, shoqëruese të kthimit të ushtrisë me Radames-in fitimtar në krye. E pandarë nga ky parafytyrim është dhe figura e tenorit brilant, të papërsëritshmit Pavarotti, i cili ka mbetur si rrallëkush i gjallë në zemrat e gjithë spektatorëve të botës.

Opera "Aida" është përshatur disa herë për film. Realizimi më i rëndësishëm ka qenë filmi italian i vitit 1953, me Luis Maksvell-in dhe Sofia Loren-in në rolet kryesorë si dhe prodhimi filmik suedez i vitit 1987.

Suksesi i operës "Aida" nuk qëndron në "lehtësinë" e gjuhës muzikore, por në tensionin e saj dramatik. Vetë Verdi e ka theksuar këtë në shumë letra të tij. Dritëhijet dramatike të veprës janë të theksuara dhe të shpërndara mjeshtërisht në tërësinë e saj. Kur veprimi ka kërkuar që muzika t'u drejtohet formave tradicionale, kompozitori gjenial nuk i ka lënë mënjandë gjetjet e mjeteve të reja shprehëse për t'i dhënë forcën e duhur konfliktit. Në ndërtimin solid dhe të gjerë të partiturës përfshihen dhe vallet, pjesët korale e "koloriti lokal", si domosdoshmëri krijimi për "grand opera"-n. Te "Aida" Verdi arriti të shkrijë stile nga më të ndryshmet, me shkathtësinë dhe lehtësinë që e karakterizonte, duke krijuar një veepër, ku ndjenja dhe mendimi kanë plazmuar një ndër kryeveprat e botës së magjismë muzikore.

Franco Zeffirelli, mbas 14 viteve i kthehet skenës si regjisor duke hapur sezonin e Teatrit La Scala më 7 Dhjetor me Operën Aida të Verdit. Mbas përfundimit të shfaqjes ai u prit me duartklojtje dhe ovacione për gjysmë ore "Bravo, Bravo" ku ishin të pranishëm edhe Romano Prodi dhe Angela Merkel. Në fund, ai tha: "Kjo mbrëmje e ktheu Operën Aida në piedestal që i takonte ndërsa është tani detyra e jonë që t'i kthejmë "La Scala"-s lavdinë e dikurshme dhe ta bëjmë atë "Opera House" të parën në botë".

...nga numri i shkuar

"Milosao" e kelij numri ishte relativisht e mirë. I kishim pretmuar Arian Lekes që do të ribotonim shkrimin e tij për teatrin, ku ai bente një shkrim të themi esesistik për të gjithë procesin që lidhet me teatrin, duke futur në mes subjektin e teatrit përmes personazheve të tij, qeverinë dhe shtetë, por edhe vete përballjen e individit shqiptar me teatrin. Duhet të themi se ishte një shkrim shumë i gjatë për Milosao, por gjithsesi i qendronte kelij numri. "Po çfarë përfaqëson teatri sot dhe pse i tremben fuqisë së tij? Ndonëse u llet audiencave të kullizuara, teatri vazhdon të mos bindet. Për lojkiten e teatërshembësve, teatri duhet shembur edhe për arsye të tjera. Përveç periudhës komuniste, kur u perul, teatri nuk i ka përmbytur kurrrë pritshmerite e pushteteve, shprehet autori. Ky plak-femije-rebel ka treguar se është më i fuqishëm se mediat, më i fuqjlole se gazetat e blera në dhjetëra vjet përmas njollimeve qeveritare dhe grantëve, më ndikues se portalet e sponsorizuara dhe më i lirë se televizionet. Teatri nuk është si Kuvendi-Parlamenti, ku duartrokitjet delegohen si vota dhe pushteti..." Në fakt, koncepti i tij për teatrin ishte shumë më tepër sesa i gjere, por edhe i parashtruar në të gjithë këndvështrimet për përballjen e individit shqiptar me teatrin.

Redaktori shtoi një shkrim kushtuar zhvillimit të Festivalit Nderkombëtar së të Drejtave të Njeriut (HRFFA), që kap edicionin e tij të trembedjete rresht në këtë vit, organizuar si zakonisht në muajin shtator. Aktiviteti mban si realizues Akademinë e Filmit dhe Multimedia "Marubi" dhe ka si temë kryesore të shenjuar "Threat to truth" ("Kercenimin ndaj të vertetes"). Në të vertete, për çdo vit, ky aktivitet që e ka vendosur Tiranen në një hartë të rendesishme kontinentale të veprimtarive filmike kryesisht alo që lidhen me të drejtat e njeriut, ka fituar një prestigj të admirueshem. Redaktori ka bere dhe një verezjeje me këtë rast, duke sqaruar se mungonin krejtësisht informacionet dhe gjithnjë e më shumë

duket se gjërat liden për në fund, duke shtuar edhe faktin se filmat pjesëmarrës ishin tejet interesante.

Redaktori botoi një cikël poetik të Petraq Ristos, ku theksoi elementin se autori shquhet për një poezi me një mendim të gjere dhe figuracion të pasur, që i shërben qartë idesë së tij. Edhe format që shpërfaqe për poezinë e tij e tregojne me shume pretendime në artin e vet... E cuditshme sepse autori nuk i solli feedback redaktorit për poezitë e tij, ndoshta i merzitur se redaktori nuk i botoi kopertinat e vellimeve të tij, por edhe se e vonoi dy javë. Nuk është çudi, që t'i ketë mbetur hatiri ngaje nuk i janë boluar të gjitha poezitë.

Redaktori shtoi një përkhim nga Paris Review të Georges Simenon, të një interviste historike të tij. Krijuesi i dedektivit të famshem Maigret dukej krejt i qarte në atë që sqaronte dhe me një stil pune që tregon realisht edhe pse është kaq prodhimtar. Me shumë kuraje e pranonte se kish bere dhe shume romane komerciale edhe pse në këte copez u fol velem sesi punonte zakonisht për romanin e tij. Në pragun e ditës së pare une e di mirë se çfare do të ndodhe në kapitullin e pare. Atehere, dite pas dite, kapitulli pas kapitulli, une e gjej ate që do të vi me pas, shtonte ai në intervisten e dikursme.

Rudolf Marku na kish sjelle një review të një romani, pothuajqë të panjohur, që tregon kalvarin e një familje në rregimin komunist. Marku i kish bere pershtypje se autori e ka botuar vete librin, duke theksuar elementin e desidences, nderkohe që autorët rëndom botojnë vete në vendin tone. "Është ky realitet që e bën librin e Marcel Hiles një veper me një vlerë të jashtezakonshme. Nuk është e rastit që ky liber është i vete - boluar nga autori", shprehet ai... Për të ardhur keq, autori e kish botuar dhe në organ tjeter shkrimin dhe për më keq akoma as nuk e lajmeroi redaktorin për ketë. Do duhet ta kemi parasysh korrektesen e tij për herë tjeter.

ARGUMENT

E, fadromat që janë nisur drejt teatrit nuk kanë kohë të presin, ato duan ushqimin e tyre, që në këtë rast është godinë e teatrit, që me shumë gjasë jo shumë kohë më vonë, do të kujtohet jo më shumë se godina e kinema "17 Nëntorit". Por, ka ende dhe pak kohë. Mbase në këto segmente të pakta kohore do të kihet mundësi që të gjykohej që t'i besohet sensibilitetit të njerëzve, kundrejt makutërisë së kullave, që nuk dinë të ndalen...

A do të harrohet edhe Teatri si kinema "17 Nëntori"?!

NGA BEN ANDONI

Me shumë gjasë po. Zyrtarët e ndryshëm kanë shumë qejf t'u tregojnë homologëve ose vizitorëve të huaj maketin e teatrit të ri, paçka se ai nuk është vënë ende në hullinë e duhur. Që do të thotë se investimi për ta prishur këtë godinë është më i madh se kur dhe pothuajse fare pranë për t'u realizuar. Nëse për kinema "17 Nëntorin", zhurma ishte jo e madhe e shumë shpejt u harrua çdo gjë, në rast prishje të ngrehinës së teatrit, mbase do të ndodhë e njëjta gjë, përveç faktit që impakti që pati presioni i shoqërisë civile, i publikut dhe intelektualëve të ndryshëm do të kujtohet më shumë. Paçka baltosjes, që i është bërë protestës, pjesëmarrjes dhe turilliloj patetikësh, që gjetën rastin të shprehen, në vetvete mbrojta e godinës ka përmblodhur si pak herë dhe me një kohëzgjatje jo të pakët, një energji të tërë. Për të drejtën. Për qytetin tonë. Fatkeqësisht, kërkesa më e mirë, që të kishim një rikonstruksion të ndërtesës dhe ta ruanim për ngarkesën që ka, nuk po merr formë. Fillimisht, e tradhtuan njerëzit që ishin gati ta mbronin me... trupat e tyre. Pastaj, u fut politika me marifetet e saj të bukura dhe epilogu...

Komisioni i Veprimtarive Prodhuese në Parlament i mbledhur për ligjin e teatrit u nda si zakonisht mes mosmarrëveshjeve të shumta dhe pas shumë debateve mazhoranca e pranoi dekretin e presidenti Meta, duke filluar korrigjimet për zhvillimin e garës për projektin e Teatrit ashtu siç edhe këshillonte BE. Në fakt, duhej t'i bënte para kësaj letre dhe jo me arrogancën e zakonshme. Nuk ndodhi kështu dhe u zbyth vetëm para forcës së



autoriteteve të Brukselit, që me takt i kanë kujtuar një nga parimet e demokracisë: garë e barabartë. Për fat të mirë, në problemim për teatrin është treguar se shoqëria mbetet ende shumë e ndjeshme ndaj

Protesta

Protesta ndaj Teatrit është shndërruar në një simbolikë, që përfaqëson grupe të ndryshme interesi, që edhe pse kanë konceptime të ndryshme, të gjithë i bashkon tashmë një gjë e përbashkët: Ruajtja e teatrit, mosndërtimi i kullave, mbrojta e parimit të konkurrencimit të barabartë dhe mbi të gjitha transparenca.

padrejtësisë. Dhe, jo më kot, në debatin për të janë përfshirë shumë forca dhe grupe shoqërore të ndryshme, nga ku janë derdhur pakënaqësi të shumta ndaj një qeverie që gjithnjë e më shumë është shumë e padrejtë dhe

Kinema "17 Nëntori"

Nëse për kinema "17 Nëntorin", zhurma ishte jo e madhe e shumë shpejt u harrua çdo gjë, në rast prishje të ngrehinës së teatrit, mbase do të ndodhë e njëjta gjë, përveç faktit që impakti që pati presioni i shoqërisë civile, i publikut dhe intelektualëve të ndryshëm do të kujtohet më shumë.

aspak tolerante. Dhe, fatkeqësisht, sado e vështirë që ka qenë gjetja e një gjuhe të përbashkët nga aktorët, aq më shumë zbuluar është treguar arroganca e subjekteve të ndryshme dhe ironia e strukturave të shtetit ndaj tyre.

Protesta ndaj Teatrit është shndërruar në një simbolikë, që përfaqëson grupe të ndryshme interesi, që edhe pse kanë konceptime të ndryshme, të gjithë i bashkon tashmë një gjë e përbashkët: Ruajtja e teatrit, mosndërtimi i kullave, mbrojta e parimit të konkurrencimit të barabartë dhe mbi të gjitha transparenca.

Kjo e fundit e varrosi kinemanë "17 Nëntori" dhe sot është e harruar krejtësisht, kjo rrezikon të varrosë njëherë e mirë edhe luftën për teatrin, pasi duhet sqaruar se qeveria Rama dhe të gjitha levat e saj tashmë e kanë kthyer në normalitet mungesën e transparencës dhe tolerancën ndaj mendimit publik.

Në javët e fundit Shqipëria është e ngërthyer me lajme të shumëllojta, që vjen nga forcimi i krimit dhe të rritja e varfërisë së njerëzve dhe këto kanë bërë që të tulates krejt shoqëria në luftën e saj. Sfida sot kërkon të luftosh në të njëjtën kohë në disa fusha njëherazi. Me pak fjalë i bie të luftosh njëkohësisht me disa kauza të pamundura, ku si gjithnjë del fitues ajo që shpall grupi i të fortëve, që artikulon me zërin e shtetit. E, fadromat që janë nisur drejt teatrit nuk kanë kohë të presin, ato duan ushqimin e tyre, që në këtë rast është godinë e teatrit, që me shumë gjasë jo shumë kohë më vonë, do të kujtohet jo më shumë se godina e kinema "17 Nëntorit". Por, ka ende dhe pak kohë. Mbase në këto segmente të pakta kohore do të kihet mundësi që të gjykohej që t'i besohet sensibilitetit të njerëzve, kundrejt makutërisë së kullave, që nuk dinë të ndalen. Maketet që u tregohen të huajve janë të bukura në zyra, por asfare në realitet.

Opinioni *i* Ditës

Nuk jeni vetëm znj. Marku

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... kurajën t'i drejtohen qytetarëve në momente të vështira të tyre. Në letrën që Prokurorja e Përgjithshme e vendit na drejtoi vetëm dy ditë më parë, ndihet pak vetmi: "Jam me mandat të përkohshëm përpara krimit dhe korrupsionit që kanë mandat të përherëshëm", shprehet ajo. Madje deri diku edhe një si lloj pasigurie dhe pafuqishmërie. E pasigurtë dhe e pafuqishme përse? Nga presioni i krimit, i politikanëve të korruptuar, i gjithë atyre që brenda vetë prokurorisë kanë pranuar paratë e kriminelëve dhe vjedhësve të shtetit dhe sot ndihen të kërcënuar? Sigurisht që po! Ky presion është i jashtëzakonshëm. Por ai duhet përballuar. Dhe përballimi i fortë dhe i shtrirë në kohë vjen vetëm kur nuk ndihesh vetëm. Si qytetarë duhet të reagojmë ndaj kësaj vetmie, qoftë edhe në miniaturë. Nuk duhet ta lëmë këtë dinjitate shtetërore që të zhgënjehet në kurajën e saj. Që të gjejë konfort vetëm nga vizitat dhe fjalët zemërdhënëse të ambasadorëve perëndimorë ose përfaqësuesve të donatorëve të huaj. Këta ndihmojnë, por nuk të ngrohin dot. Mbështetjen e vërtetë të madhe ta jep vetëm i yti, populli yt! Po ku jemi ne, si qytetarë? Nëse prokurorja ndihet e vetmuar në "përkohshmërinë" e emërimit të saj, na takon ne t'i bëzajmë të mos



ndihet e tillë. Reforma në drejtësi është një aleate e jashtëzakonshme. Edhe pse e vonuar, e shigjetuar, mes stërkëmbësash, përfoljesh e sulmesh mjerane personale, kjo reformë po ecën. Është aleati i saj profesional më i mirë. Nëse Po-

licinë e sotme të Shtetit e ndihmon me informacion policia kriminale e Belgjikës për të kapur "të fortët" tanë të krimit, kjo tregon se policia shqiptare është rritur në imazhin e saj në Perëndim dhe, edhe pse, ende e shënuar nga ethet

e kaluara të kanabisit, po i qëndron përpara krimit. Në krye të saj është një shërbëtar publik i sprovuar. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rreth shtatë vjet që nuk pyet ndikime politike dhe qindra dosjet e kallëzimeve të tij penale këto vite janë lëndë e parë e jashtëzakonshme, si për prokurorinë edhe për strukturat speciale të reformës në drejtësi që do të ngrihen shumë shpejt, për të luftuar korrupsionin. Edhe në krye të tij qëndron një shërbëtar publik i sprovuar. Nuk jeni vetëm znj. Marku. Lind pyetja: po ne si qytetarë, ku jemi, për Prokurorin tonë të Përgjithshme që po na sqaron (por ky sqarim është edhe një thirrje për mbështetje) me një letër? Në mbrojtje të Prokurorisë Speciale të Rumanisë

u ngritën me qindra mijëra vetë në sheshet e Bukureshtit për muaj të tërë. Zj. Marku, nëse doni të jeni një shërbëtarë publike e këtij vendi dhe të mbaheni mend gjatë, mos u ndjeni e vetmuar. Të jeni e sigurt se ju nuk do të keni fatin e Prokurorisë Speciale të Rumanisë, Laura Kodruta Kovesi, heroinës moderne të popullit rumun, e cila ngriti në afro 5 vjet 1870 akuza për korrupsion ndaj zyrtarëve më të lartë shtetërorë të vendit të saj, duke bërë që mbi 80 ministra, zv/ministra, drejtorë dhe funksionarë të tjerë të shohin dyert e burgut për krime institucionale dhe korrupsion dhe që u shkarkua. Nëse Ju bëni një të dhjetën e punës së Kovesit, të jeni e sigurt se nuk ju preket asnjë fije floku. Nëse heroina moderne rumune u shkarkua në korrik të këtij viti nga Presidenti i Republikës së Rumanisë, pasi këtij të fundit partia në fuqi i ishte kërcënuar se do të niste procedurat për shkarkimin e tij, nëse nuk hiqte Kovesin, të jeni e sigurt se këtu tek ne nuk ka asnjë burrë nënë t'ju prekë sadopak institucionalisht për veprimet që do të ndërmerri në emër të ligjit dhe të interesit të shqiptarëve. Ndoshta si qytetarë do të duhej të shkonim të paktën me qindra në dyert e prokurorisë për t'u solidarizuar me Prokurorin tonë të Përgjithshme, pas kundërveprimit të prokurorëve që u sprapsën nga presioni i krimit. Ende nuk e kemi bërë këtë. Por ende nuk është kurrë vonë që ta bëjmë.

Në letrën që Prokurorja e Përgjithshme e vendit na drejtoi vetëm dy ditë më parë, ndihet pak vetmi: "Jam me mandat të përkohshëm përpara krimit dhe korrupsionit që kanë mandat të përherëshëm", shprehet ajo. Madje deri diku edhe një si lloj pasigurie dhe pafuqishmërie. E pasigurtë dhe e pafuqishme përse?

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Dje në "Deutsche Welle"

Gjermani thirri arsyes!

Nga Jens Thurau

(vijon nga faqja 1)

... në vend. Tema e vetme e tyre është, se refugjatët janë shkaku i të gjitha problemeve. Ata bëjnë sehir kur në demonstratat e tyre bëhen përhëndetje hitleriane, ata heshtin, kur sulmohen restorante hebreje. Tema të tjera - mungesa e banesave, çështjet sociale - atyre nuk u interesojnë.

AFD KRYESON NË LINDJE

Por ata kryesojnë në sondazhin e fundit të ARD-së për herë të parë kundrejt socialdemokratëve (SPD), partisë prestigjioze, partisë më të vjetër gjermane. E ky është vetëm fiksimi i një çasti në një zhvillim, që ende nuk ka marrë fund. Në landet lindore të Gjermanisë AfD-ja sipas anketimeve arrin mesatarisht vendin e parë.

E megjithatë: 82 përqind e të pyeturve në sondazh nuk kanë vendosur për AfD. Po të hedhësh një sy në vendet e tjera europiane kupton, që Gjermania megjithatë rezultoi mjaft mirë. Në Itali populistët janë në pushtet, Hungaria dhe Polonia qeverisen prej populistëve. Ndërsa në Uashington gjëmon Donald Trumpi.

TË GJITHË VOTUESIT E AFD ESKTREMISTË TË DJATHTË?

18 përqind e të pyeturve pra do të votonin për AfD-në, një parti antidemokratike, ksenofobe, plot reminishenca, pa empati për minoritetet. Një parti, e cila vë në pikëpyetje ndarjen e pushteteve. A janë këta 18 përqind të gjithë edhe të këtij mendimi?

Në fakt, jo. Nëse në Chemnitz, ashtu sikurse ndodhi, mijëra qytetarë i bashkohen një marshimi në demonstratë, në krye të së cilës himnizohet Adolf Hitleri dhe bëhet thirrje për të sulmuar shtetin, atëherë kjo më keq s'ka ku të vejë. Por kjo është edhe shenjë, që njerëzit nuk gjejnë një vend tjetër, në të cilin të mundet të shkarkojnë nderin dhe zhgënjimin e tyre. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për azilkerkues dhe



probleme bashkëjetese, por ndër të tjera edhe për këtë. Këtu është fjala për vlerësim, respekt, ndjenjë, se nuk të marrin seriozisht, kur në një botë të pasigurtë po shtohen gjithnjë e më shumë frikërat.

Prej shumë kohësh të gjitha partitë i kanë lënë pas dore temat thelbësore si mungesa e banesave, pabarazia sociale. Nga një atmosferë e tillë gjithmonë historia ka treguar, se pavarësisht ku, përfitojnë ata që i thjeshtojnë më së shumti gjërat dhe nxisin urrejtjen. Por në Gjermaninë e pasluftës, fillimisht vetëm në Perëndim, ka qenë ndryshe. Nisur nga përvoja prej krimeve të tmerrshme të nazistëve, shumica e gjermanëve mendonin për

pajtim, maturi dhe sa më pak debate polarizuese. Tani gjërat kanë ndryshuar. Anë e mbanë ndihet acarimi, në rrugë e nëpër qytete. **DEMOKRATËT DUHET TË REFLEKTOJNË**

Politika e vjetër, e etabluar luan rolin e vet kështu: e pëshqjelluar në grindje të hapura, për muaj të tërë, pa impulse të vërteta për zgjidhje lidhur me politikën e azilit. Hesh, gjithashtu, që prej kohësh në qeveri ka një konsensus, që në thelb duhen mbyllur kufijtë e Europës. Kushdo e kupton, se këtu kemi të bëjmë edhe me larje personale hespesh, si p.sh. mes Kancelares dhe kritikëve në radhët e saj, kryesisht në radhët e kristiansocialëve, partisë bavareze simotër e kristi-

andemokratëve të Kancelares. Ndërsa në mediet nuk ia dalim, që një pjesë të popullsisë, e cila voton për AfD-në pa qenë vërtetë ekstremiste e djathtë, ta vlerësojmë pozitivisht dhe ta pasqyrojmë atë vërtetë ashtu siç është me motivet e saj.

Tani është e nevojshme, që shoqëria duhet ta mësojë nga e para bashkëbisedimin. Njerëzit e arsyeshëm në të gjitha partitë e etabluara - të tillë ka - duhet t'i çojnë ato në parada e t'u japin mikrofonin për të mbrojtur demokracinë. Ndërsa mediet duhet të kujtojnë një parim të vjetër e të mirë të tyre: të raportojnë. Jo duke u bërë palë vetëm me një anë - e jo vetëm me një anë të mirë.

HOROSKOPI

DASHI

Kushtojani kohën dhe energjinë tuaj të tjerëve, por mos merrni pjesë në çështje që nuk ju shqetësojnë aspak. Bëni më shumë kujdes për problemet shëndetësore.

DEMI

Mos u shqetësoni dhe mos e humbni besimin tuaj teksa takoni disa persona të profilit të lartë. Disa plane të rëndësishme do të nisnin të vihen në zbatim duke ju sjellë përfitime të reja financiare.

BINJAKET

Mos shpenzoni shumë për çështjet e argëtimit. Kjo është një kohë e shkëlqyer për vendosjen e kontakteve profesionale në vende të tjera. Disa tensione mund të shfaqen në sfond në jetën bashkëshortore.

GAFORJA

Investimet janë të rekomanduara, por kërkonti këshilla të përshtatshme. Asgjë nuk është e pamundur për sa kohë që ekziston një vullnet për të kapërcyer çdo vështirësi.

LUANI

Shmangni tejkalimin e shpenzimeve nëse shkoni për pazar. Jetë në çift do të nis të përmirësohet, por duhet më shumë angazhim nga ana juaj. Parashikohet të merrni disa ditë pushimi dhe relaksimi.

VIrgJERESHA

Mundohuni të relaksoheni duke kaluar më shumë momente në shtëpi si dhe duke shmangur netët e vonshme jashtë. Asnjë shpresë për romancë sot, por ju mund të merrni një lajm të mirë në punë.

PESHORJA

Mundohuni të përdorni energjinë tuaj të lartë për të mirën personale. Ju do të keni një dëshirë për të fituar para të shpejta. Të afërmit dhe miqtë mund të vijnë për një mbrëmje të mrekullueshme.

AKREPI

Kultivoni një qëndrim bujar ndaj jetës. Nuk duhet të mendoni negativisht lidhur me kushtet e jetesës. Është mendimi i varfër që shkatëron aromën e jetës dhe vret shpresën për të jetuar një jetë të kënaqshme.

SHIGJETARI

Nuk jeni në gjendje të bëni ndonjë përparim për shkak të qëndrimit tuaj pesimist. Është koha për ju që të kuptoni se shqetësimi ka vonuar fuqinë tuaj të të menduarit. Mendoni pozitivisht dhe gjërat do të shkojnë mirë.

BRICJAPI

Përjetoni dashuri të devotshme dhe të pastër. Sot do të kaloni mbrëmjen më të mirë të jetës tuaj me bashkëshortin. Edhe situata ekonomike do të jetë e mirë ndaj mund të bëni blerjet që dëshironi.


UJORI

Ndryshimi i vendit të punës do t'ju japë kënaqësi mendore. Dikush nga e kaluara juaj ka gjasë t'ju kontaktojë dhe t'ju bëjë ditën të paharrueshme. Që nga ajo kohë, presioni i punës e kishte penguar jetën tuaj në çift.

PESHQIT

Sot mund të merrni disa lajme të mira. Nëse keni aplikuar për një vend të ri pune gjasat janë që të keni sukses. Në dashuri jo gjithçka është rozë. Mund të ketë luhajtje në çift, por ato janë brenda normales.

Fjalëkryqi (1)



- 32. Nuk duan t'ia dinë për rezik.
34. Fillojnë një temë.
35. Beenhakker trainer.
36. Andrea, fantazist i Milan.
39. Pak stabilitet.
41. Janë çastet.
43. Një mund të jetë edhe sheqeri
45. Qeni që... kthehet në shtëpi.
47. Ishin rivalët e athinasve.
48. Kufijtë e hartës
49. Fillojnë detyrën

VERTIKAL

- 1. Ka humbur hijen.
2. Jetonin në Olimp.
3. Eshhtë si hipoteze, pandehje
4. Ishte ambient me odaliska.
5. Ishin kaçakë.
6. Thyhet me dy çapa.
7. Në radhë të parë.
8. Janë marrëveshje që nënshkruhen.
9. Bëhen për të zgjedhur.
11. Lauda ish pilot i Formula 1.
13. Andre in Imoralisti.
16. Ashtu qoftë në kishë.
17. Janë edhe ato të sigurimit
19. Fillojnë lojë.
22. Rruga e Molnar.
26. Një dalje me gjysmë bikini
29. Mund të jenë kundërmuese.
30. Zgjat tre muaj.
33. Janë thirrjet publike.
35. Një Altin mesfushor.
37. Radiotelevizioni publik (sigla).
38. Votim pa kufij.
39. Një saks kur s'është ai.
40. Një tip për të kërcyer.
42. Roman pa fillim edhe pa fund
44. Ekstremit në letër.
46. Harris aktor

HORIZONTAL:

- 1. ...Art i Andy Warhol.
3. Gjysmë sahati.
5. Mund të jenë intensive me barna.
9. Në krye të vendit.
10. Ente Ndërtimi Urbane.
12. Ishte sheshi i akeve.
14. Fundi i Turandot.
15. Eshhtë meremetim.
17. Në radhë të parë.
18. Eshhtë e famshme ajo Pallati 171 në tv.
20. Mbyllin një hark.
21. Bëhen për të vënë në lojë.
22. Me stop në box
23. Fillojnë mpirjen.
24. Pak iniciativë.
25. Fitohet nga çikilisti.
27. Ente Autonome.
28. Institute Autonome Mat.
30. Janë ndenjëse në park.
31. Takohen në ekstreme.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Mbyllin fushatat.
2. Sapo fillojnë.
3. Eshhtë tregti me objekte të shenjta.
9. Ekstremit në duel.
10. Fillojnë ceremoninë.
12. U shkrua nga Emile Zola.
13. Janë gabimet me guajtjet e lira.
16. Mbarojnë fare.
17. Ishin punë pa shpërbim.
18. Një thirrje parandaluese.
19. Regjisori i Aromë gruaje.
21. Fillojnë një motiv
22. Një Montenegro në shishe.
23. Qendër ditore.
24. Ente Autonome Rajonale.
25. Aleksandër kompozitor
28. I ka njëloj një trakt.
30. Eshhtë muzika më e kollajtë.
32. Kazan regjisor.

VERTIKAL


- 1. I famshmi Pacino.
2. Regjisori i Për një grusht dollarë.
4. Mund të kthehen në mllefe.
5. Jetojnë në bjeshtë të tillë
6. Një... dollar
7. Në mes të një kanali.
8. Janë efektet e padëshiruara të barnave.
9. Eshhtë arti në skenë.
10. Mund të jetë elektrik dhe telefonik.
11. U shkrua nga Edgar Allan Poe.
13. Janë klasat që nuk takohen.
14. Para Diego në Kaliforni.
15. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
16. Qyteti i përjetshëm.
20. Inicialet e Moravia-s.
24. Janë skuadrat.
26. Organizma Humanitare Përmet.
27. Fillojnë sefte.
29. Një fjalë goxha.
31. Woods i golfit
33. Ishin rapsodë të akejve
35. Heche aktore
36. Një patriar bibliik.
38. Gjysmë limiti.
41. Falas pa kufij.
42. Institute Projektimi Europiane.
43. Inicialet e Delon.
44. Mbyllin një shtëpi.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

9x9 Sudoku grid with numbers 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

Completed 9x9 Sudoku grid.

Argëtimit filozofik

Nëse pasuria udhëhiqet nga injoranca, është më e keqe se varfëria, sepse mund t'i shtyjë gjërat më me forcë në drejtimin e gabuar.

Besoj vetëm vetes tënde në jetë, sepse njerëzit nuk të kuptojnë, të godasin, e mbi të gjitha kënaqen kur të lëndojnë.

Toni Montana

Disa njerëz mendojnë për gjërat ashtu si janë dhe pyesin 'pse'. Unë i nderroj ashtu si dëshiroj të jenë dhe mendoj 'pse jo'.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

Word search grid with letters and words like GODARD, IROON, etc.

Word search puzzle with vertical text: PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR

Argëtimit filozofik

Thënie të mënçura

- "Një jetë e kaluar në gabime nuk është vetëm më e ndershme, por dhe më e dobishme se një jetë e kaluar në asgjë." George Bernard Shaw
- Arsyeja se pse njerëzit ta marrin mirësinë për dobësi, është se ti je duke i'u dhënë shumë, më shumë seç meritojnë. Jason Statham
- Në një botë të shëmtuar dhe të mjeruar, madje edhe më të pasurit nuk mund të blejnë veçse shëmtimi dhe mjerimin.
- Leximi është njeriu i plotë, duke folur bëhesh i gatshëm , duke shkruar bëhesh i qartë. Francesco Bacone

